



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
***Qeveria –Vlada-Government***  
**Ministria e Administratës Publike-Ministrarsvo Javne Uprave**  
**Ministry of Public Administration**  
**Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil - Departament o Administraciji Civilne**  
**Sluzbe**  
**Department of Civil ServiceAdministration**

“Pyetje me përgjigje të shumëfishta  
për procedurën e rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës”

Gusht 2011

## Tabelë Përmbledhëse

|                                                                                                                                              |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje.....                                                                                                                                   | 3  |
| Pjesa I. Njohuri të përgjithshme për çdo nëpunës të shërbimit civil.....                                                                     | 5  |
| Kreu 1: Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës.....                                                                                 | 5  |
| Kreu 2: Pyetje nga njohuritë mbi procedimin administrativ (Ligji i procedurave administrative dhe Ligji për konfliktet administrative) ..... | 17 |
| Kreu 3: Pyetje mbi njohuritë mbi shërbimin civil të Kosovës.....                                                                             | 27 |
| Kreu 4: Pyetje mbi njohuritë në organizimin, funksionimin e administratës publike dhe qeverisjes lokale.....                                 | 36 |
| Kreu 5: Pyetje mbi njohuritë e përgjithshme për BE-në, institutionet dhe ligjin European.....                                                | 44 |
| Pjesa II. Aftësi të Përgjithshme: arsyetimi dhe menduarit në mënyre llogjike dhe analitike .....                                             | 53 |
| Kreu 1: Pyetje të llogjikës - matematike bazike .....                                                                                        | 53 |
| Kreu 2: Pyetje të llogjikës - numerike .....                                                                                                 | 60 |
| Kreu 3: Pyetje të llogjikës - arsyetuese, deduksionit dhe të aftësive për zgjidhjen e problemeve ....                                        | 66 |

## Hyrje

Ky dokument është një përmbledhje e 296 pyetjeve me përgjigje të shumëfishta të përgatitura nga Projekti “Përgatitja e DASHC për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil”, financuar nga DFID (Department for International Development) i Mbretërisë së Bashkuar, me kërkesë të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil (DASHC), në Ministrinë e Administratës Publike të Republikës së Kosovës.

Këto pyetje propozohen të përdoren në ndihmë të DASHC dhe institucioneve të shërbimit civil, që organizojnë procedurat e rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës.

Përmbledhja prej 296 pyetjesh është ndarë në dy pjesë kryesore. PJESA E PARË përfshin 214 pyetje që kanë për qëllim të testojnë pjesën e njohurive të përgjithshme lidhur me organizimin dhe funksionimin e shtetit dhe administratës së Kosovës. Kjo pjesë grumbullon pyetje nga 5 krerë kryesorë: Kreu 1, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (50 pyetje); Kreu 2, rregullat e procedimit administrativ (40 pyetje); Kreu 3, shërbimi civil i Kosovës (40 pyetje), Kreu 4, organizimi dhe funksionim i administratës publike dhe qeverisja lokale në Kosovë dhe Kreu 5, Bashkimi Evropian, historik, institucionet dhe ligji evropian në përgjithësi. Kjo pjesë është menduar që të shërbejë për testimin e kandidatëve në njohuritë e tyre mbi elementet bazë të organizimit dhe funksionimit të administratës publike, elemente që mendojmë që çdo kandidat për në shërbimin civil, pavarësisht nga kategoria dhe natyra e punës duhet ti zotërojë në një masë të kënaqshme.

PJESA E DYTE, përfshin rreth 80 pyetje të një natyre krejtësisht tjetër, që mendohet të jenë pjesë e testimit të aftësive të përgjithshme të kandidatëve në procedurat e rekrutimit të shërbimit civil. Kjo pjesë përfshin pyetje që synojnë të testojnë kapacitetin intelektual për të arsyetuar dhe menduar në mënyre logjike të kandidatëve për shërbimin civil. Kjo pjesë është e ndarë në tre lloje të ndryshme pyetjesh.

Kreu 1, përfshin 30 pyetje të logjikes bazike matematike. Këto pyetje synojnë të testojnë aftësitë e punës bazike me numrat, si psh. mbledhje, zbritje, pjesëtim, shumëzim, përqindje apo mesatare. Kreu 2, përfshin 30 pyetje të logjikes bazike numerike. Këto pyetje synojnë të testojnë aftësitë e logjikës numerike si psh. kuptimi i shkallës dhe drejtimit dhe ndryshimit në një seri numrash të thjeshtë, apo identifikimin logjik të trendit zbritës apo ngritës në një seri numrash dhe masën e kësaj ngritje apo zbritje.

Kreu 3, përfshin 20 pyetje të logjikës arsyetuese, deduktuese dhe të zgjidhjes së problemeve. Këto pyetje synojnë të testojnë aftësinë për të kuptuar, identifikuar dhe zgjidhur probleme dhe për të zbatuar parimet e përgjithshme të logjikës në situata të caktuara të dhëna.

Pyetjet janë të menduar për procedurën e testimit me shkrim të nëpunësve civilë dhe mund të përdoren në këtë procedurë për kategori/nivele të ndryshme të nëpunësve të shërbimit civil. Në mënyrë të veçantë pyetjet e pjesës së parë, janë menduar për tu përdorur në pjesën e testimit të njohurive të përgjithshme që lidhen me vendin e punës, ndërsa pyetjet e pjesës së dytë janë menduar për tu përdorur në mënyrë të veçantë në testimin e aftësive të përgjithshme logjike dhe analitike të kandidatëve për shërbimin civil.

Rekomandohet që për çdo proces testimi me shkrim, krahas pyetjeve të tjera, nga pjesa e parë të zgjidhen në mënyrë rastësore, 2 pyetje nga secili kre (10 pyetje gjithsej), dhe po kështu nga pjesa e dytë të zgjidhen 2 pyetje për secilin kre (6 pyetje gjithsej).

## **Pjesa I. Njohuri të përgjithshme për çdo nëpunës të shërbimit civil**

### **Kreu 1: Njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës**

#### **1. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i saktë:**

- a. **Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollin e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar në Kushtetutë.**
- b. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve.
- c. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit mes tyre.

#### **2. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i sakte:**

- a. Republika e Kosovës është Republikë Presidenciale.
- b. Republika e Kosovës është Republikë Parlamentare.**
- c. Republika e Kosoves është Republikë gjysëm-presidenciale

#### **3. Barazia para ligjit është një nga parimet bazë të shtetit të së drejtës (shtetit ligjor). Barazi para ligjit do të thotë:**

- a. Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa asnjë diskriminim.**
- b. Të gjithë shtetasit e Kosovës kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime.
- c. Të gjithë shtetasit e Kosovës duhet të përfitojnë njësoj nga fondet e buxhetit të Kosovës.
- d. Të gjithë shtetasit e Kosovës kanë të garantuar punësimin në shërbimin civil.

#### **4. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, mund të kufizohen vetëm me ligj. Kjo do të thotë që ligji:**

- a. mund të kufizojë një të drejtë apo një liri themelore për një qytetar të caktuar.
- b. mund të parashikojë të drejtat dhe liritë themelore që mund të kufizohen, shkaqet, organin dhe procedurën për kufizimin e një të drejtë apo një lirie themelore.**
- c. mund të parashikojë të drejtat dhe liritë themelore që mund të kufizohen.

**5. Politika fiskale është nën autoritetin e:**

- a. Qeverisë dhe Parlamentit të Kosovës.
- b. Bankës Qëndrore të Kosovës.
- c. Auditorit të Pëgjithshëm të Kosovës.
- d. Bankës Qendrore Europiane.

**6. Mandati i deputetëve (anëtarëve) të Kuvendit të RKS është:**

- a. Katër vjeçar.
- b. Pesë vjeçar.
- c. Tre vjeçar

**7. Numri i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosoves është:**

- a. 100
- b. 140
- c. 120
- d. 99

**8. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i sakti:**

- a. Kuvendi është institucioni ligjvënës i Republikës së Kosovës që miraton ligjet dhe aktet nënligjore për zbatimin e tyre.
- b. Kuvendi është institucioni që përcakton drejtimet kryesore të politikës shtetërore në Kosovë dhe i shndërron ato në ligje.
- c. Kuvendi është institucioni ligjvënës i Republikës së Kosovës.

**9. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i sakti:**

- a. Kuvendi i Kosovës ushtron pushtetin legjislativ dhe mbikqyr punën e Qeverisë.
- b. Kuvendi i Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv dhe drejton punën e Qeverisë.
- c. Kuvendi i Kosovës mbrohet kushtetueshmërinë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

**10. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë;**

- a. Kuvendi miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme.
- b. Kuvendi miraton legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

- c. Kuvendi ratifikon traktatet ndërkombëtare .
- d. Kuvendi miraton buxhetin e Republikës së Kosovës.

**11. Cili nga pohimet e me poshtëme është i saktë;**

- a. Kuvendi miraton përbërjen e qeverisë sipas propozimit të Kryeministrit.
- b. Kuvendi miraton kryeministrin, ministrat dhe zëvendësministrat.
- c. Kuvendi miraton programin e qeverisë sipas propozimit të Kryeministrit.

**12. Ligjet në RKS miratohen nga Kuvendi i Kosovës dhe dekretohen nga Presidenti i Republikës. Të drejtën e iniciativës për propozimin e ligjeve e ka:**

- a. Vetëm Qeveria e RKS.
- b. Vetëm qeveria e RKS, jo më pak se 10 deputetë dhe jo më pak se 25 mijë zgjedhës.
- c. Vetëm Presidenti i Republikës së Kosovës.
- d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e RKS, çdo deputet i Kuvendit dhe së paku dhjetëmijë qytetarë.
- e. Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e RKS, çdo deputet i Kuvendit, së paku dhjetëmijë qytetarë dhe Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës.

**13. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Një ligj përcakton rregulla të përgjithshme dhe abstrakte sjelljeje.
- b. Një ligj rregullon një çështje konkrete dhe individuale.
- c. Një ligj është një deklaratë qëllimi i Kuvendit për atë se çfarë duhet të bëjë Qeveria.

**14. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Ligjet miratohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
- b. Ligjet miratohen nga Parlamenti i Kosovës dhe shpallen nga Presidenti i Republikës.
- c. Ligjet miratohen nga Qeveria e Kosovës dhe shpallen nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
- d. Ligjet miratohen nga Parlamenti i Kosovës dhe nga Qeveria e Kosovës sipas delegimit të dhënë nga Kuvendi i Kosovës.

**15. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i më sakti:**

- a. Ligjet miratohen me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

- b. Ligjet miratohen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, përveç atyre ligjeve me interes vital që votohen me një shumicë tjetër të përcaktuar shprehimisht nga Kushtetuta.
- c. Ligjet miratohen me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç atyre ligjeve me interes vital që votohen me një shumicë tjetër të përcaktuar shprehimisht nga Kushtetuta.

**16. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i sakti:**

- a. Ligji hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
- b. Ligji hyn në fuqi në datën e përcaktuar shprehimisht në vete ligjin.
- c. Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.
- d. Ligji hyn në fuqi 30 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveçse në rastin kur në ligj është e përcaktuar ndryshe.

**17. Cili nga ligjet e mëposhtëme NUK është ligj me interes vital që i nënshtrohen miratimit me shumicë të përbërë:**

- a. Ligji për përdorimin e gjuhëve.
- b. Ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare.
- c. Ligji për zgjedhjet në Kuvendin e Kosovës.
- d. Ligji për zgjedhjet lokale.
- e. Ligji për arsimin.

**18. Cili nga këto forma NUK përbën instrument të mbikqyrjes Parlamentare (të Kuvendit) mbi punën e Qeverisë e RKS:**

- a. Pyetjet dhe interpelancat.
- b. Mocionet e mosbesimit.
- c. Komisionet parlamentare.
- d. Kontrolli i specializuar nga institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit.
- e. Rishikimi gjyqësor i akteve administrative.

**19. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Presidenti i RKS, zgjidhet me zgjedhje të drejpërdrejta nga populli.
- b. Presidenti i RKS, zgjidhet nga Kuvendi i RKS.
- c. Presidenti i RKS, zgjidhet nga Qeveria e RKS pas marrjes së pëlqimit të Kuvendit.
- d. Presidenti i RKS, zgjidhet me referendum.

**20. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**



- a. Kandidati për President i RKS, i propozohet Kuvendit nga Kryeministri.
- b. Kandidati për President i RKS, i propozohet Kuvendit nga të paktën 30 deputetë të Kuvendit të Kosovës.
- c. Kandidati për President i RKS, i propozohet Kuvendit nga forca politike që ka mazhorancën në Kuvend.

**21. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i saktë:**

- a. Presidenti RKS, është kreu i Qeverisë dhe përcakton drejtimet kryesore të politikës shtetërore të RKS.
- b. Presidenti RKS, është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.
- c. Presidenti RKS, është përfaqësues i popullit dhe kontrollon punën e Qeverisë së RKS.

**22. Cila nga këto kompetenca NUK është kompetencë e Presidentit të RKS:**

- a. Presidenti përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë.
- b. Presidenti shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
- c. Presidenti ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.
- d. Presidenti thërret mbledhjen e parë të Kuvendit të Kosovës.
- e. Presidenti është komandant suprem i forcave të sigurisë së Kosovës.
- f. Udhëheq politikën e jashtme të vendit.

**23. Cila nga këto kompetenca NUK është kompetencë e Presidentit të RKS:**

- a. Presidenti është komandant suprem i forcave të sigurisë së Kosovës.
- b. Presidenti udhëheq politikën e jashtme të vendit.
- c. Presidenti nxjerr dekrete në pajtim me kushtetutën e RKS.
- d. Presidenti emëron zëvendëskryeministrin dhe zëvendësministrat.
- e. Presidenti garanton funksionimin kushtetutës të institucioneve të përcaktuara në Kushtetutë.

**24. Cila nga shprehjet e mëposhtëme është e sakte:**

- a. Presidenti i Republikës së Kosovës drejton punën e Qeverisë.
- b. Presidenti i Republikës së Kosovës është shef i Qeverisë.
- c. Presidenti i Republikës së Kosovës është kreu i shtetit.

**25. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i sakti:**

- a. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Kuvendi për shkaqet dhe në rastet e përcaktuara në kushtetutë.
- b. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Gjykata Supreme e Kosovës në rastet e dhënies së një dënimi penal nga kjo e fundit;
- c. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Gjykata Kushtuese e Kosovës në rastet e shkeljeve të rënda të kushtetutës.
- d. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**26. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse është dënuar për kryerjen e një krimi të rëndë.
- b. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse nuk është i afte për të ushtruar përgjegjësitë e postit për shkak të një sëmundje të rëndë.
- c. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse nuk gëzon më besimin e shumicës së anëtarëve të tij.
- d. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse Gjykata Kushtuese ka përcaktuar se presidenti ka bërë një shkelje të rëndë të Kushtetutës.

**27. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Presidenti i Republikës ka nje mandat 5 vjeçar.
- b. Presidenti i Republikës pas përfundimit të mandatit mund të zgjidhet vetëm edhe një herë.
- c. Presidenti i Republikës ka nje mandat 5 vjet pa të drejtë rizgjedhjeje.
- d. Presidenti i Republikës zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë.

**28. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i sakte:**

- a. Presidenti i Republikës emëron dhe shkarkon gjyqëtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe pas konsultimit me Kryeministrin.
- b. Presidenti i Republikës emëron dhe shkarkon gjyqëtarët e Republikës së Kosovës me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe pas konsultimit me kryetarët e gjykatave ku bëhet emërimi.
- c. Presidentim i Republikës emëron dhe shkarkon gjyqëtarët e Republikës së Kosovës me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

- d. Presidentim i Republikës emëron dhe shkarkon gjyqëtarët e Republikës së Kosovës me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe pas konsultimit me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

**29. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i sakte:**

- a. Qeveria RKS përbëhet nga Presidenti i RKS, Kryeministri, Zëvendës-Kryeministri/at dhe Ministrat.
- b. Qeveria RKS përbëhet nga Kryeministri, Zëvendës-Kryeministri/at dhe ministrat.
- c. Qeveria RKS përbëhet nga Kryeministri, Zëvendës-Kryeministri/at, Ministrat dhe Zëvendës-Ministrat.

**30. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i sakte:**

- a. Qeveria e RKS, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës,
- b. Qeveria e RKS për punën e vet i përgjigjet Kryeministrit të Kosovës.
- c. Qeveria e RKS për punën e vet i përgjigjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
- d. Qeveria e RKS për punën e vet i përgjigjet drejtpërdrejtë popullit të Kosovës.

**31. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Qeveria e RKS, propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit.
- b. Qeveria e RKS, propozon buxhetin e RKS.
- c. Qeveria e RKS, i propozon Kuvendit projektligje dhe vendime të nevojshme për zbatimin e ligjeve.
- d. Qeveria e RKS, ushtron dhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk iu janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore.

**32. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Qeveria e RKS, udhëzon dhe mbikqyr punën e organeve të administratës.
- b. Qeveria e RKS, udhëzon dhe mbikqyr punën e organeve të vetëqeverisjes lokale.
- c. Qeveria e RKS, udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike.

**33. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Për vendimet që merr Qeveria, mban përgjegjësi vetëm Kryeministri, si Kryetar i Qeverisë.

- b. Për vendimet që merr Qeveria, mban përgjegjësi vetëm Kryeministri, si Kryetar i Qeverisë apo Zëvendëskryeministri që ka drejtuar mbledhjen e Qeverisë në mungesë të Kryeministrit.
- c. Për vendimet që merr Qeveria, mban përgjegjësi vetëm ministria propozuese apo Kryeministri/Zëvendëskryeministri kur propozimi vjen nga këto të fundit.
- d. Për vendimet që merr Qeveria, mbajnë bashkëpërgjegjësi, Kryeministri, Zëvendëskryeministrat dhe ministrat.

**34. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës përbëhet nga:**

- a. Gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës.
- b. Gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës.
- c. Gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Shërbimit Civil.

**35. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Gjyqtarët e gjykatave në Kosovë emërohen, riemërohen dhe shkarkohen nga Presidenti me propozim të Qeverisë së RKS.
- b. Gjyqtarët e gjykatave në Kosovë emërohen, riemërohen dhe shkarkohen nga Presidenti me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- c. Gjyqtarët e gjykatave në Kosovë emërohen, riemërohen dhe shkarkohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

**36. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat e Kosovës.
- b. Pushteti Gjyqësor në Kosovë ushtrohet nga gjykatat e Kosovës dhe organet e tjera administrative të përcaktuara me ligj.
- c. Pushteti Gjyqësor në Kosovë ushtrohet nga gjykatat e Kosovës dhe Gjykata e Hagës për krimet kundër njerëzimit.

**37. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë është Gjykata Kushtetuese e Kosovës.
- b. Autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë është Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- c. Autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë është Gjykata Supreme e Kosovës.
- d. Autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë është Këshilli i Pavarur mbikqyrës Shërbimit civil.

**38. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Një vendim gjyqësor mund të ankimohet gjithmonë në një gjykatë tjetër si rregull të një shkalle më të lartë.
- b. E drejta e ankesës ndaj një vendimi gjyqësor është e garantuar, përveç nëse me ligj përcakohet ndryshe.
- c. Një vendim gjyqësor mund të ankohet në një gjykatë më të lartë vetëm nëse ligji përcakton shprehimisht të drejtën e ankesës.

**39. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Prokurori i shtetit është institucion i pavarur.
- b. Prokurori i shtetit është institucion në varësi të Qeverisë.
- c. Prokurori i Shtetit është institucion në varësi të Këshillit të Prokurorisë.

**40. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Prokurori i shtetit është institucioni përgjegjës për ndjekjen penale në Republikën e Kosovës.
- b. Prokurori i shtetit është institucioni përgjegjës për ndjekjen penale dhe për ndjekjen e shkeljeve të tjera të karakterit administrativ.
- c. Prokurori i shtetit është institucioni përgjegjës për ndjekjen penale për shkeljet penale kundër shtetit.

**41. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës përputhmërisë ligjeve me Kushtetutën.
- b. Gjykata Kushtetuese është shkalla e fundit e ankimit gjyqësor në RKS.
- c. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përgjegjës për mbikqyrjen e respektimit të Kushtetutës nga Qeveria dhe organet e tjera administrative.

**42. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Gjykata Kushtetuese vendos për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën e RKS.
- b. Gjykata Kushtetuese vendos mbi konfliktin mes kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentit dhe Qeverisë së Kosovës.
- c. Gjykata Kushtetuese vendos mbi përpueshmërinë e rregulloreve të miratuara nga Qeveria e Kosovës me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

**43. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës në territorin lokal përkatës.
- b. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në bazë të zgjedhjeve lokale.
- c. Vetëqeverisja lokale ushtrohet drejpërdrejtë nëpërmjet referendumeve lokale.

**44. Cila nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë degët territoriale të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore.
- b. Njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë komunat.
- c. Njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë degët territoriale të ministrive dhe komunat.

**45. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.
- b. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore kufizohet në sigurimin e përputhjes vetëm me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- c. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën, ligjet dhe politikat qeveritare të fushës.

**46. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin.
- b. Komunat kanë kompetenca të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyra e veta në pajtim me ligjin.
- c. Komunat kanë të drejtë të nënshkrojnë marrëveshje ndërkombëtare.

**47. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Komunat kanë kompetencë të caktojnë taksa dhe tatime lokale.
- b. Komunat kanë kompetencë të administrojnë shërbime publike lokale dhe të mbledhin tarifa për dhënie të këtyre shërbimeve.
- c. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetueshmërinë e ligjeve apo akteve të qeverisë, të cilat çenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e saj, në rast se është prekur nga ai ligj apo akt.

- d. Komunitat kanë të drejtë të propozojnë Kuvendit të Kosovës miratimin e një ligji në interes të tyre.

**48. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Avokati i Popullit ka si mision zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis qytetarëve dhe organeve të administratës publike.
- b. Avokati i Popullit ka si mision mbikqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike;
- c. Avokati i Popullit ka si mision ushtrimin e ndjekjes penale në Republikën e Kosovës.

**49. Cila nga kompetencat e mëposhtëme NUK i përket Avokatit të Popullit:**

- a. Mbikqyrja e të drejtave të të burgosurve në institucionet e vuajtjes të denimit .
- b. Mbikqyrja e respektimit nga organet e administratës publike të së drejtës së qytetarëve për informimin mbi dokumentet shtetërore.
- c. Anullimi i një akti administrativ të një organi të administratës publike që cënon të drejtat apo interesat e ligjshme të një qytetari.
- d. Mbikqyrja e respektimit të të drejtave të fëmijëve në institucionet e arsimit publik.

**50. Cila nga kompetencat e mëposhtëme NUK i përket Auditorit të Përgjithshëm të Republikës:**

- a. Kontrolli i veprimtarisë ekonomike të institucioneve publike dhe personave të tjerë juridike shtetërore.
- b. Kontrolli i përdorimit të fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal
- c. Kontrolli i detyrimeve tatimore dhe e pagesës së tyre në personat juridikë privatë.
- d. Kontrolli i mbledhjes të hyrave publike nga organet kompetente qendrore apo lokale.
- e. Veprimtaritë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët shteti ka një pjesë të aksioneve ose kur kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

**51. Cila nga kompetencat e mëposhtëme NUK i përket Auditorit të Përgjithshëm të Republikës:**

- a. Kontrolli i përdorimit të fondeve publike nga organet e pushtetit qendror.
- b. Kontrolli i përdorimit të fondeve publike nga organet e pushtetit qendror.
- c. Kontrolli i mbledhjes të hyrave publike nga organet kompetente qendrore apo lokale.
- d. Kontrolli i korrektësisë së mbajtjes së bilanceve dhe pasqyrave financiare dhe detyrimeve tatimore nga personat juridikë privatë.
- e. Kontrolli i veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët shteti ka një pjesë të aksioneve ose kur kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.



## **Kreu 2: Pyetje nga e njohuritë mbi procedimin administrativ (Ligji i procedurave administrative dhe ai për konfliktet administrative)**

### **52. Ligji për procedurat administrative:**

- a. Përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës publike.
- b. Përcakton rregullat për zgjidhjen e kontesteve administrative.
- c. Përcakton rregullat në marrëdhënien ndërmjet organit të administratës dhe qytetarit.
- d. Përcakton rregullat për hartimin dhe miratimin e akteve normative nga Qeveria Kosovës.

### **53. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Dekretimi i nje ligji nga Presidenti i RKS është akt i te drejtës kushtetuese.
- b. Dekretimi i nje ligji nga Presidenti i RKS është akt i te drejtës administrative
- c. Dekretimi i nje ligji nga Presidenti i RKS është akt i te drejtës private.

### **54. Akti administrativ mund të përkufizohet si:**

- a. Një akt juridik i njëanshëm.
- b. Një akt juridik i dyanshëm
- c. Nje akt juridik i shumanshëm.

### **55. Akti administrativ mund të përkufizohet si:**

- a. Një akt juridik që rregullon një marrëdhënie juridike konkrete.
- b. Nje akt juridik që përcakton rregulla të përgjithshme dhe abstrakte sjelljeje për subjektet që i drejtohet.
- c. Një akt juridik që përcakton detyrime konkrete për organin e administratës publike.

### **56. Cili nga parimet e mëposhtëme NUK bën pjesë në parimet e përgjithshme të ligjit për procedurën administrative:**

- a. Parimi i ligjshmërisë.
- b. Parimi i barazisë para ligjit.
- c. Parimi i qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë
- d. Parimi i bindjes

- e. Parimi i balancimit të interesave publike dhe private.

**57. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK ka të bëjë me parimin e proporcionalitetit në veprimtarinë e administratës publike:**

- a. Organet e administratës publike do të përdorin mjetet që janë në përpjestim (proporcion) me qëllimet që synohen të arrihen.
- b. Të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave fizikë dhe juridikë, mund të kufizohen vetëm në pajtim me ligjin dhe në masën që është e domosdoshme për të realizuar një interes publik të rëndësishëm.
- c. Në çdo rast organi i administratës publike duhet të dalë me një vendim përfundimtar.
- d. Në çdo rast organet e administratës publike do të vlerësojnë nëse qëllimi i kërkuar mund të realizohet me masa sa më pak represive pa komprometuar efektivitetin e tyre.

**58. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK ka të bëjë me parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e administratës publike:**

- a. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- b. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre.
- c. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.
- d. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative me eficiencë dhe shpejtesi.

**59. Cilë nga pohimet e mëposhtëme NUK ka të bëjë me parimin e qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në veprimtarinë e administratës publike:**

- a. Organet e administratës publike do të jenë të qëndrueshme në veprimtarinë e tyre administrative me qëllim të respektimit të pritjeve legjitime të personave fizikë dhe juridikë.
- b. Organet e administratës publike në të njëjtën situatë faktike dhe ligjore duhet të japin një vendim përfundimtar të njëjtë.
- c. Organet e administratës Publike duhet të balancojnë interesat publike me ato private.
- d. Nje vendim i organit të administratës publike nuk mund të përbejë një ndryshim të pajustificuar të nje vendimarrje të mëparshme të dhënë në të njëjtën situatë faktike dhe ligjore.

**60. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i saktë:**

- a. Procedimi administrativ mund të fillojë vetëm me kërkesë të personit/palës të interesuar, ose me kërkesën e publikut.
- b. Procedimi administrativ mund të fillojë vetëm me iniciativën e vetë organit të administratës publike, me kërkesë të personit/palës të interesuar, ose me kërkesën e publikut.
- c. Procedimi administrativ mund të fillojë vetëm me iniciativën e vetë organit të administratës publike, me kërkesë të personit/palës të interesuar, me kërkesën e publikut apo me kërkesë të Avokatit të Popullit në raste të caktuara.
- d. Procedimi administrativ mund të fillojë me iniciativën e vetë organit të administratës publike, me kërkesë të personit/palës të interesuar, ose me kërkesën e publikut.

**61. Cili nga pohimet e mëposhtëme pasqyron më saktë të drejtën e palës për tu dëgjuar në procedimin administrativ:**

- a. Pala e interesuar në një procedim administrativ ka të drejtë të dëgjohet përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga organi i administratës publike, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji.
- b. Organi i administratës mund të dëgjojë palën përpara marrjes së vendimit përfundimtar, nese kjo është e nevojshme për sqarimin e situatës faktike të çështjes në fjalë.
- c. Pala e interesuar në një procedim administrativ mund të shpreh mendimet, sugjerimet e saj lidhur me faktet apo ligjin, në një procedim administrativ.

**62. E drejta e inspektimit të dosjes në procedimin administrativ do të thotë:**

- a. E drejta e çdo njeriu për të kërkuar njohjen dhe informimin mbi dokumentet shtetërore.
- b. E drejta e palës së interesuar të njihet me informacionin dhe dokumentet e administruara në dosjen e procedimit administrativ në të cilën është palë.
- c. E drejta e organit të administratës publike të njihet me çdo informacion të nevojshëm për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim dhe daljen me një vendim përfundimtar.
- d. E drejta e organit të administratës publike të kërkojë nga një organ tjetër, transferimin e informacionit që ka ne dispozicion dhe që i shërben për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim.

**63. Cili nga pohimet e mëposhtëme shpreh parimin e detyrimit të vendimarrjes së administratës publike:**

- a. Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të marrin një vendim për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizikë dhe juridikë.
- b. Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, marrin vendime në përputhje me ligjin material.

- c. Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, marrin vendime në përputhje me ligjin procedural.
- d. Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, veprojnë në përputhje me ligjin.

**64. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Procedimi administrativ përfundon brenda kohës së nevojshme për shqyrtimin e plotë të çështjes dhe zgjedhjen e saj nga organi i administratës publike.
- b. Procedimi administrativ përfundon gjithmonë brenda një periudhe kohore prej 3 muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës.
- c. Procedimi administrativ përfundon gjithmonë brenda një periudhe kohore prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.
- d. Procedimi administrativ përfundon sa më shpejtë të jetë e mundur por sidoqoftë brenda periudhës kohore të parashikuar nga ligji, me përjashtim të rastit kur shtyrja bëhet e detyrueshme për shkak të situatave të jashtëzakonshme. Në rast se ligji i posaçëm nuk parashikon një periudhë kohore (afat) për përfundimin e procedimit, ai duhet të përfundojë brenda 3 muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

**65. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Organi administrativ, të cilit i drejtohet ankimi administrativ shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.
- b. Organi administrativ, të cilit i drejtohet ankimi shqyrton vetëm ligjshmërinë e aktit të kontestuar.
- c. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton vetëm rregullsinë e aktit të kontestuar.

**66. Ministria e Punëve Publike të Kosovës ka miratuar një leje ndërtimi për një banesë private në territorin e Komunës së Prishtinës. Leje e ndërtimit në këtë rast është një:**

- a. Akti administrativ i vlefshëm nëse është në përputhje me kushtet dhe standartet urbanistike.
- b. Akti administrativ relativisht i pavlefshëm nëse është në kundërshtim me kushtet dhe standartet urbanistike.
- c. Akt i së drejtes civile.
- d. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm.

**67. Komuna Pejë ka miratuar një leje ndertimi për një banesë private në territorin e Komunës së Prishtinës. Leja e ndërtimit në këtë rast është një akt administrativ:**

- a. I vlefshëm nëse është në përputhje me kushtet dhe standartet urbanistike.
- b. Relativisht i pavlefshëm nëse është në kundërshtim me kushtet dhe standartet urbanistike.
- c. Akti administrativ i absolutisht i pavlefshëm.

**68. Auditori i përgjithshëm i Kosovës, gjatë një kontrolli në departamentin e tatim taksave ka konstatuar se vlerësimi tatimor i bërë një subjekti tregtar privat është më i ulët seç duhej të ishte për shkak të një gabimi material në llogaritje nga inspektori tatimor. Bazuar në këtë konstatim, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës i ka njoftuar subjektin tregtar një akt administrativ në të cilin i kërkon shlyejën e detyrimit tatimor në masën e duhur. Në këtë rast akti administrativ i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës është një akt administrativ:**

- a. I vlefshëm nëse konstatimi i bërë nga Auditori i Përgjithshëm është i saktë.
- b. Relativisht i pavlefshëm nëse konstatimi i bërë nga Auditori i Përgjithshëm është i saktë.
- c. Relativisht i pavlefshëm nëse kjo ka ndodhur pas shume kohësh dhe detyrimi tatimor është parashkruar.
- d. Absolutisht i pavlefshëm.

**69. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike dhe mund të injorohet nga pala që detyrohet.
- b. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm prodhon pasojat juridike si një akt i vlefshëm deri në momentin kur shpallet si i pavlefshëm.
- c. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm prodhon pasojat juridike si një akt i vlefshëm deri në momentin që pala e interesuar kërkon shpalljen e tij si të pavlefshëm.

**70. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i vërtetë:**

- a. Ankimi administrativ ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet në çdo kohë.
- b. Ankimi administrativ ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet 30 ditë nga njoftimi i tij.
- c. Ankimi administrativ ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet 30 ditë nga publikimi i tij.
- d. Ankimi ndaj një akti absolutisht të pavlefshëm mund të bëhet 30 ditë nga hyrja e tij në fuqi.

**71. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i vërtetë:**

- a. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të palës së interesuar.
- b. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të palës apo me iniciativën e organit epror të organit që e ka nxjerrë atë.
- c. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të palës apo me iniciativën e organit epror të organit që e ka nxjerrë atë.
- d. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të shpallet i tillë me kërkesë të çdo personi.

**72. Mjetet e ankimit në rrugë administrative, ndaj një akti administrativ (përfshire refuzimin apo heshtjen administrative) janë:**

- a. Vetëm kërkesa për rishqyrtim.
- b. Vetëm ankesa administrative.
- c. Vetëm kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa administrative.
- d. Kërkesa për rishqyrtim, ankesa administrative dhe padia.

**73. Kërkesa për rishqyrtim si një nga mjetet e ankimit në rrugë administrative i drejtohet dhe është në kompetencë të:**

- a. Drejtuar organit përgjegjës për aktin (që ka nxjerrë akti apo ka refuzuar nxjerrjen e tij);
- b. Nëpunësit epror të nëpunësit përgjegjës për aktin.
- c. Organit epror të organit ku ushtron detyrën nëpunësi përgjegjës për aktin.
- d. Gjykatës kompetente për konfliktet administrative.

**74. Ankesa administrative si një nga mjetet e ankimit në rrugë administrative i drejtohet dhe është në kompetencë të:**

- a. Drejtuar nëpunësit përgjegjës për aktin (që ka nxjerrë akti apo ka refuzuar nxjerrjen e tij);
- b. Nëpunësit epror të nëpunësit përgjegjës për aktin.
- c. Organit më të lartë të atij përgjegjës për aktin.
- d. Gjykatës kompetente për konfliktet administrative

**75. Ankimi administrativ i bërë në formën e ankesës duhet të dorëzohet:**

- a. Tek organi që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit administrativ,
- b. Tek organi më i lartë i organit që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit të ankimuar.
- c. Në zgjedhjen e ankuesit të pikës a apo b.

**76. Ankimi administrativ i bërë në formën e kërkesës për rishqyrim dorëzohet:**

- a. Tek organi që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit administrativ.
- b. Tek organi me i lartë i organit që ka nxjerrë apo refuzuar nxjerrjen e aktit të ankimuar.
- c. Në zgjedhjen e ankuesit të pikës a apo b.

**77. Afati për ankimin administrativ është :**

- a. 30 ditë në çdo rast.
- b. 60 ditë në çdo rast.
- c. 30 ditë në rast të ankimit ndaj një akti administrativ apo refuzimit për të nxjerrë aktin dhe 60 ditë nga dorëzimi i kërkesës për nxjerrjen e aktit në rastin e heshtjes së plotë administrative.

**78. Afati për ankimin administrativ ndaj një akti administrativ apo refuzimit për të nxjerrë aktin fillon të rrjedhë nga dita kur:**

- a. Akti apo refuzimi është miratuar nga organi i administratës publike.
- b. Pala njihen me përmbajtjen e aktit administrativ.
- c. Ankuesi ka marrë dijeni për aktin apo refuzimin për nxjerrjen e tij apo ai është shpallur sipas legjislacionit të posaçëm.
- d. c ose d, së bashku.

**79. Afati për ankimin administrativ ndaj mosveprimit (heshtjes së plote administrative) fillon të llogaritet nga dita kur:**

- a. Akti apo refuzimi është miratuar nga organi i administratës publike.
- b. Nga dorëzimi i kërkesës për nxjerrjen e aktit.
- c. Ankuesi ka marrë dijeni për heshtjen.
- d. c ose a, se bashku.

**80. Pala që cenohet nga një akt administrativ në të drejtat apo interesat e saj të ligjshme mund të ankohet si më poshtë:**

- a. Të zgjedhë ti drejtohet organit administrativ që ka nxjerrë aktin apo organit epror të organit të administratës që ka nxjerrë aktin.
- b. Të zgjedhë ti drejtohet vetë organit të administratës që ka nxjerrë aktin, organit epror të organit të administratës që ka nxjerrë aktin apo drejtpërdrejtë gjykatës.
- c. Ti drejtohet drejtpërdrejtë gjykatës kompetente për konstatimin administrativ.

**81. Cilat janë format e veprimtarisë administrative sipas ligjit të procedurave administrative të Kosovës:**

- a. Vetëm akti administrativ (individual apo kolektiv).
- b. Akti administrativ dhe kontratat administrative.
- c. Akti administrativ dhe aktet reale.
- d. Akti administrativ, akti real dhe kontratat administrative.

**82. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Nje akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga organi epror i organit që e ka nxjerrë atë akt.
- b. Nje akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga vetë organi që e ka nxjerrë atë akt.
- c. Nje akt administrativ i pavlefshëm, revokohet nga vetë organi që e ka nxjerrë atë akt.

**83. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i vërtetë:**

- a. Një akt administrativ i pavlefshëm, revokohet nga organi epror i organit që e ka nxjerrë atë akt.
- b. Një akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga vetë organi që e ka nxjerrë atë akt.
- c. Një akt administrativ i pavlefshëm, shfuqizohet nga organi epror i organit që e ka nxjerrë atë akt.

**84. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Dokumentet zyrtare (publike) që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, vetëm në rastet e parashikuar shprehimisht nga ligji.
- b. Dokumentet zyrtare (publike) që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, vetëm në rastet e parashikuar shprehimisht nga ligji dhe nëse kanë të bëjnë me një procedim administrativ mund të inspektohen nga pala e interesuar në këtë procedim.
- c. Dokumentet zyrtare (publike) që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.



**85. Cila nga aktet e mëposhtëme është akt administrativ:**

- a. Akte administrative me karakter rregullativ;
- b. Çdo vendim të organit të administratës publike, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave.
- c. Akte që nxirren nga organet e administratës publike në kuadrin e transaksioneve private, në të cilat administrata publike është palë.

**86. Gjykata kompetente për zgjedhjen e konflikteve administrative, si rregull, shqyrton:**

- a. Ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative.
- b. Ligjshmërinë dhe rregullsinë e akteve përfundimtare administrative
- c. Rregullësinë e akteve përfundimtare administrative.

**87. Për cilin nga tipet e mëposhtëme të akteve, NUK mund zhvillohet konflikti administrativ:**

- a. Kundër heshtjes së organit administrativ epror që zgjidh ankimin ndaj një akti administrativ.
- b. Kundër akteve administrative, që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm, të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato çenojnë të drejtat e ligjshme të palëve.
- c. Kunder vendimit të dhënë nga organi epror në zgjedhjen e ankesës të bërë nga një qytetar ndaj një akti administrativ të paligjshëm.

**88. Qëllimi i kontrollit gjyqësor mbi aktet administrative është:**

- a. Sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë çenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike,
- b. Sigurimi i ligjshmërisë të veprimtarisë së organeve të administratës publike.
- c. Fillimi i ndjekjes penale për nëpunësin përgjegjës për aktin e paligjshëm.
- d. Pohimet “a” dhe “b”, më sipër, së bashku.

**89. Cilat nga kategoritë e mëposhtëme NUK kanë të drejtën të nisin një konflikt administrativ në gjykatën kompetente:**

- a. Personi fizik si dhe personi juridik, të cilit akti administrativ përfundimtar i ka shkelur ndonjë të drejtë apo interes ligjor.
- b. Një organ tjetër i administratës publike i cili vepron në mbrojtje të interesave publike
- c. Organi i administratës publike që ka nxjerre aktin nëse vlerëson se akti i tij ka qënë i pa rregullt.

- d. Avokati i Popullit, i cili vepron në mbrojtje të interesave publike.
- e. Shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike.

**90. Paraqitja e padisë në konfliktin administrativ:**

- a. Si rregull, nuk pezullon ekzekutimin e aktit administrativ.
- b. Pezullon ekzekutimin e aktit administrativ.
- c. E bën aktin administrativ të paefektshëm.
- d. Pezullon ekzekutimin e aktit për periudhën deri në dhënien e vendimit të shkallës së parë.

**91. Në cilin nga rastet e mëposhtëme gjykata kompetente për konfliktet administrative NUK mund të hedhë poshtë, me vendim, padinë kundër një akti administrativ:**

- a. Padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohëshme.
- b. Akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ.
- c. Është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj.
- d. Akti që kontestohet është vetëm pjesërisht i ligjshëm.
- e. Ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerrë në konfliktin administrativ, për të njëjtën çështje.

**92. Cili nga aktet e mëposhtëme administrative mund të ekzekutohet forcërisht:**

- a. akti, veprimi i të cilit është pezulluar;
- b. akti kundër të cilit është bërë ankim me efekt pezullues;
- c. akti që hyn në fuqi vetëm pas miratimit të një organi tjetër administrativ, i ndryshëm nga organi që e ka nxjerrë aktin.
- d. akti administrativ, kundër të cilit është paraqitur një ankim në gjykatën kompetente.

### **Kreu 3: Pyetje mbi njohuritë mbi shërbimin civil të Kosovës**

**93. Marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil është marrëdhënie juridike:**

- a. E të drejtës së punës.
- b. E të drejtës administrative.**
- c. E të drejtës civile.

**94. Cili nga pohimet e mëposhtëm përbën karakteristikën thelbësore të shërbimit civil:**

- a. Ushtrimi i autoritetit publik.**
- b. Punësimi në një institucion të administratës publike.
- c. Kryerja e një detyre të rëndësishme shtetërore.
- d. Marrëdhënia e besnikërisë me pushtetin politik.

**95. Cila nga veprimtaritë e mëposhtëme NUK është veprimtari tipike që kryhet nga nëpunës civil:**

- a. Marrja pjesë në formulimin e politikave.
- b. Monitorimi i zbatimit të rregullave.
- c. Hartimi dhe përgatitja e strategjive.
- d. Pastrimi i ambienteve të institucionit.**
- e. Ndjekja e zbatimit të kërkesave ligjore nga qytetarët dhe bizneset.

**96. Cila nga veprimtaritë e mëposhtëme NUK është veprimtari tipike që kryhet nga nëpunës civil:**

- a. Marrja pjesë në formulimin e politikave.
- b. Monitorimi i zbatimit të rregullave.
- c. Hartimi dhe përgatitja e strategjive.
- d. Vozitja e një automjeti të një ministrie në shërbim të drejtorisë të financave.**
- e. Ndjekja e zbatimit të kërkesave ligjore nga qytetarët dhe biznesi.

**97. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK duhet të përbëjë ‘cilësi’ thelbësore të nëpunësit civil:**

- a. Profesionalizmi.
- b. Integriteti
- c. Paanësia politike

- d. Përgjegjshmëria
- e. Besnikëria politike

**98. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për hartimin e politikave të menaxhimit të shërbimit civil.
- b. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të politikave të shërbimit civil.
- c. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për propozimin e politikave në fushën e pagave dhe shpërblimeve.
- d. Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të nëpunësve civil ndaj vendimeve lidhur me marrëdhëniet e punësimit në shërbimin civil.

**99. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është:**

- a. Një institucion i pavarur që i raporton Kuvendit të Kosovës.
- b. Një institucion në varësi të Qeverisë së RKS-se.
- c. Pjesë e sistemit gjyqësor të RKS-se.

**100. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është institucion përgjegjës për:**

- a. Hartimi e politikave të shërbimit civil në RKS.
- b. Për mbikqyrjen e ligjshmërisë së menaxhimit në shërbimin civil.
- c. Menaxhimin e shërbimit civil në RKS.
- d. Rekrutimin e nëpunësve të shërbimit civil.

**101. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka kompetencë në:**

- a. Zgjedhjen e ankesave të nëpunësve civilë ndaj akteve të menaxhimit lidhur me marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil.
- b. Nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të nëpunësit civil.
- c. Hartimin e politikave shtetërore të shërbimit civil.

**102. Cila nga kategoritë e mëposhtëme të personelit është pjesë e shërbimit civil të Kosovës:**

- a. Stafi mësimor i sistemit arsimor.
- b. Stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe performuesit të artit,

- c. Personeli civil i punësuar në policinë e Kosovës.
- d. Zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës.
- e. Nëpunësit e administratës të Kuvendit të Kosovës.
- f. Zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës.

**103. Cila nga kategoritë e mëposhtëme të personelit janë pjesë e shërbimit civil të Kosovës:**

- a. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.
- b. Stafi mësimor i sistemit arsimor.
- c. Stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe performuesit të artit.
- d. Zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës

**104. Cila nga kategoritë e mëposhtëme të personelit NUK është pjesë e shërbimit civil të Kosovës:**

- a. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.
- b. Kryetarët e komunave.
- c. Personeli civil i punësuar në Doganat e Kosovës.
- d. Personeli civil i punësuar në policinë e Kosovës.

**105. Cili nga pozitat e mëposhtme në një ministri NUK është pozite e shërbimit civil:**

- a. Drejtori i nje Departamenti.
- b. Shef i nje divizion.
- c. Këshilltar i ministrit.
- d. Sekretari i Përgjithshëm.

**106. Cila nga pozitat e mëposhtëme në një ministri NUK është pozitë e shërbimit civil:**

- a. Drejtori i nje Departamenti.
- b. Shef i nje divizion.
- c. Sekretari i Përgjithshëm.
- d. Punonjësi i pastrimit.

**107. Procedura e pranimit në shërbimin civil, përveçse në pozicionet e larta drejtuese organizohet nga:**

- a. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil,
- b. Vetë institucioni që ka vendin e lirë ku do të punësohet nëpunësi.

- c. Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike.
- d. Ministria e Administratës Publike.

**108. Cili nga parimet e mëposhtëm NUK është parim i përzgjedhjes për pranimin në shërbimin civil:**

- a. Parimi i meritës.
- b. Parimi i transparencës.
- c. Parimi i besnikërisë politike.
- d. Parimi i profesionalizmit.
- e. Parimi i paanësise dhe mosdiskriminimit.

**109. Cila nga kërkesat e mëposhtme NUK është kërkesë e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.**

- a. Shtetësia e Republikës së Kosovës.
- b. Mosha madhore.
- c. Zotërimi i gjuhës angleze.
- d. Zotësia e plotë për të vepruar.

**110. Cila nga kërkesat e mëposhtme NUK është kërkesë e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.**

- a. Shtetësia e Republikës së Kosovës.
- b. Mosha mbi 30 vjeç.
- c. Zotësia e plotë për të vepruar.
- d. Posedim të të drejtave civile dhe politike.

**111. Cila nga kërkesat e mëposhtme NUK është kërkesë e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.**

- a. Shtetësia e Republikës së Kosovës.
- b. Zotësia e plotë për të vepruar.
- c. Vendbanimi në Kosovë.
- d. Posedim të të drejtave civile dhe politike.

**112. Për secilën gradë të punës në shërbimin civil ka hapa në mënyrë progresive. Avancimi i nëpunësit civil nga hapi aktual në një hap më të lartë bëhet në bazë të :**

- a. Vjetërsisë në punë.
- b. Rezultateve në punë.
- c. Vjetërsisë në punë dhe rezultateve në punë

**113. Çdo kategori funksionale e nëpunësve civilë përfshin gradat e punës. Këto grada përcaktohen në bazë të:**

- a. Përgjegjësisë dhe kompleksitetit të punës në pozitën përkatëse.
- b. Aftësive profesionale të nëpunësit që ushtron detyrën në pozitën përkatëse.
- c. Kualifikimeve dhe përvojës të nëpunësit që ushtron detyrën në pozitën përkatëse.

**114. Cila nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e nevojave për trajnim individual ose të grupeve të nëpunësve civilë.
- b. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e përshtatshmërisë së nëpunësit civil për avancim në karrierë.
- c. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e ekzistimit e kushteve për shndërrimin e punës provuese në emërim ose në shkarkim;
- d. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte në përgjegjësinë disiplinore të nëpunësit.

**115. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte në vazhdimin ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.
- b. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për përcaktimin e nevojave për trajnim individual ose të grupeve të nëpunësve civilë.
- c. Rezultatet e vlerësimit të punës kanë ndikim dhe efekte për pranimin në shërbimin civil.

**116. NUK përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil:**

- a. Dorëheqja.
- b. Arritja e moshës së pensionit.
- c. Marrja e detyrës së funksionarit publik (politik).
- d. Paaftësinë e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore;
- e. Dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër.

**117. NUK përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil:**

- a. Paaftësia e përhershme për ushtrimin e detyrës zyrtare për arsye shëndetësore;
- b. Dënimi nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër.
- c. Arritja e moshës së pensionit.
- d. Kryerja e detyrimeve ushtarake.

**118. Autoritet kompetent për iniciimin e procedurave për shkarkimin e sekretarëve të përgjithshëm në një ministri është:**

- a. Ministri që drejton ministrinë përkatëse.
- b. Kryeministri i Kosovës.
- c. Ministria e Administratës Publike.
- d. Këshilli Mbikëqyrës i Shërbimit Civil.

**119. Autoritet kompetent për marrjen e vendimit për shkarkimin e sekretarëve të përgjithshëm në një ministri është:**

- a. Ministri që drejton ministrinë përkatëse.
- b. Kryeministri i Kosovës.
- c. Ministria e Administratës Publike.
- d. Komisioni i posaçëm disiplinor i ngritur për këtë qëllim me vendim të Qeverisë.

**120. Autoritet kompetent për marrjen e vendimit për shkarkimin e një nëpunësi të nivelit drejtues në një komunë është:**

- a. Kryetari i Komunës.
- b. Këshilli i Komunës.
- c. Komisioni i posaçëm disiplinor i ngritur për këtë qëllim në komunën përkatëse.
- d. Ministria e Administratës Publike.

**121. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i sakte:**

- a. Nëpunësi civil nuk do ti zbatojë urdhërat që kërkojnë kryejn e një vepre në kundërshtim me ligjin.
- b. Nëpunësi civil nuk do ti zbatojë urdhërat që kërkojnë moskryerjen e një vepre në kundërshtim me ligjin.
- c. Nëpunësi civil nuk do ti zbatojë urdhërat që janë jashtë kompetencave të urdhëruesit.
- d. Nëpunësi civil nuk do ti zbatojë urdhërat që jepen me gojë nga eprori i tij.



**122. Në rast dyshimi se një urdhër i marrë kërkon kryerjen e një veprë në kundërshtim me ligjin, nëpunësi civil duhet të:**

- a. Zbatojë urdhërin, pa e vënë në diskutim atë.
- b. Vetëm të refuzojë të zbatojnë urdhërin dhe të vazhdojë punën normalisht.
- c. Të refuzojë zbatimin e urdhërit dhe të kërkojë urdhër me shkrim nga eprori i tyre i drejpërdrejtë.

**123. Organi kompetent për marrjen e masave për shkelje të rënda administrative në shërbimin civil, për nëpunësit me përjashtim të nëpunësve të nivelit drejtues është:**

- a. Eprori direkt i nëpunësit që ka kryer shkeljen disiplinore.
- b. Titullari i institucionit ku ushtron detyrën nëpunësi që ka kryer shkeljen disiplinore.
- c. Komisioni disiplinor i institucionit.
- d. Këshilli i Mbikëqyrjes së shërbimit civil.

**124. Cili nga rastet e mëposhtëme NUK përbën shkak për pezullimin parandalues të një nëpunësi civil nga detyra:**

- a. Kundër nëpunësit ka filluar ndjekja penale për kryerjen e një veprë penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
- b. Nëpunësi mbahet në arrest në pritje të gjykimit.
- c. Prania e nëpunësit në zyrë mund të pengojë hetimin disiplinor.
- d. Nëpunësi kryen detyrimet ushtarake.

**125. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i saktë:**

- a. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet nëpërmjet konkurimit të hapur dhe publik ku marrin pjesë kandidatë që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të pranimit nga brenda dhe jashtë shërbimit civil.
- b. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet nëpërmjet një konkurrimi transparent ku kanë të drejtë të marrin pjesë nëpunësit civil të klasifikuar në pozita të larta drejtuese ose në pozita të barazvlefshme me to.
- c. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet drejpërdrejtë nga titullari i institucionit me vendin vakant.
- d. Përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil bëhet drejpërdrejtë nga Qeveria e RKS për institucionet e ekzekutivit apo nga titullari i institucionit të pavarur apo komunës me vendin vakant.

**126. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Periudha provuese aplikohet në çdo rast në të cilin nëpunësi emërohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil.
- b. Periudha provuese nuk aplikohet në rast se nëpunësi është punësuar në një pozitë tjetër nëpërmjet ngritjes në karrierë.
- c. Periudha provuese aplikohet në çdo rast në të cilin nëpunësi emërohet në një pozitë tjetër të një kategorie funksionale më të lartë.
- d. Periudha provuese aplikohet në çdo rast në të cilin nëpunësi emërohet në një pozitë tjetër të një grade më të lartë.

**127. Cili nga dënimet e mëposhtëm NUK përbën masë disiplinore në shërbimin civil të Kosovës:**

- a. Vërejtje gojore.
- b. Vërejtje me shkrim që vendoset në dosjen personale të shërbyesit civil.
- c. Dënim me gjobë deri 50% të pagës mujore.
- d. pezullimi nga puna dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj.

**128. Cila nga të drejtat e mëposhtëme nuk përbën të drejtë themelore për një nëpunës civil në hetim disiplinor për kryerjen e një shkeljeje disiplinore?**

- a. E drejta për të ditur akuzën dhe bazat e saj;
- b. E drejta e mbulimit nga kostos për ndihme juridike
- c. E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u përgjigjur;
- d. E drejta e ankesës.

**129. Mosha e pensionit të nëpunësve civilë të Kosovës është:**

- a. 65 vjeç për nëpunësit e gjinisë mashkullore dhe 60 vjeç për nëpunësit e gjinisë femërore.
- b. 70 vjeç për nëpunësit e gjinisë mashkullore dhe 65 vjeç për nëpunësit e gjinisë femërore.
- c. Gjashtëdhjetepesë (65) vjeç.
- d. Nuk ka një moshë të caktuar pensioni.

**130. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Në shërbimin civil të Kosovës, pensionimi është një e drejtë që nëpunësi mund ta ushtrojë kur plotëson disa kushte të caktuara (psh, mosha dhe vitet e kontributit).
- b. Në shërbimin civil të Kosovës, pensionimi është një e drejtë dhe detyrim dhe nëpunësi del në pension kur mbush moshën përkatëse, duke mos patur më të drejtë të qëndrojë në detyrë.

- c. Në shërbimin civil të Kosovës, pensionimi është një e drejtë dhe detyrim dhe nëpunësi del ne pension kur mbush moshën përkatëse dhe vitet e kontributeve, duke mos patur më të drejtë të qëndrojë në detyrë.

**131. Kundër vendimit të Këshillit të pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosoves, pala e pakënaqur:**

- a. Nuk mund të paraqesë ankim;
- b. Mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente.
- c. Mund të ankimohet në gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
- d. Mund të ankimohet në Kuvendin e Kosovës.

**132. Këshilli i Pavarur Mbikqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, kur gjykon se akti i shkarkimit nga detyra të një nëpunësi civil është i paligjshëm, mund të:**

- a. Vendos kthimin në detyrë të nepunesit.
- b. Vendos kalimin e tij në një listë pritje dhe emërimin në pozitën e parë që do të behet vakante në të ardhmen.
- c. Vendos marrjen e një mase disiplinore ndaj personit apo personave përgjegjës për shkarkimin e paligjshëm.
- d. Te rekomandojë kthimin në pozitën e mëparshme të nepunësit të shkarkuar.

**133. Cili nga pohimet e mëposhtëme, NUK është e drejtë e Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës?**

- a. Të njoftoje me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim, nëse ky i fundit nuk e ka zbatuar brenda afatit të parashikuara nga ligji vendimin e KPMSH-së.
- b. Te marrë një masë disiplinore ndaj personit apo personave përgjegjës për shkarkimin e paligjshëm të një nëpunësi.
- c. Të vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- d. Te ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avancimin e nëpunësve civilë.

#### **Kreu 4: Pyetje mbi njohuritë në organizimin, funksionimin e administratës publike dhe qeverisjes lokale**

**134. Administrata në Republikën e Kosovës ushtrohet nga institucionet e administratës të drejpërdrejtë dhe të tërthortë shtetërore. Cili nga kategoritë institucionale të mëposhtëme është institucion i administratës të drejpërdrejtë shtetërore:**

- a. Komunat, përse kanë të bëjnë me kompetencat e tyre vetanake dhe te zgjeruara.
- b. Komunat, përse kanë të bëjnë me kompetencat e deleguara shtetërore.**
- c. Organet e pavarura të administratës shtetërore me statusin e personit juridik.
- d. Personat juridike jo shtetërore, te cilëve u jane deleguar kompetenca shtetërore

**135. Administrata në Republikën e Kosovës ushtrohet nga institucionet e administratës të drejpërdrejtë dhe të tërthortë shtetërore. Cila nga kategoritë institucionale të mëposhtëme është institucion i administratës të drejpërdrejtë shtetërore:**

- a. Komunat, përse kanë të bëjnë me kompetencat e tyre vetanake dhe te zgjeruara.
- b. Organet e pavarura të administratës shtetërore me statusin e personit juridik.
- c. Ministrinë**
- d. Personat juridike jo shtetërore, të cilëve u jane deleguar kompetenca shtetërore.

**136. Administrata në Republikën e Kosovës ushtrohet nga institucionet e administratës të drejpërdrejtë dhe të tërthortë shtetërore. Cila nga kategoritë institucionale të mëposhtëme është institucion i administratës së tërthortë shtetërore:**

- a. Komunat, përse kanë të bëjnë me kompetencat e tyre vetanake dhe te zgjeruara.**
- b. Organet e larta të administratës shtetërore.
- c. Organet qendrore të administrates shtetërore
- d. Organet lokale të administratës shtetërore

**137. Administrata në Republikën e Kosovës ushtrohet nga institucionet e administratës të drejpërdrejtë dhe të tërthortë shtetërore. Cili nga institucionet e meposhtëme mund të kategorizohet si institucion i administratës së tërthortë shtetërore:**

- a. Ministria e Administratës Publike.
- b. Instituti Albanologjik i Kosovës.
- c. Komuna e Prishtinës, përse ka të bëj me kompetencat në lëmin e furnizimit me ujë të pijshëm te popullatës.**

d. Zyra e Kryeministrit.

**138. Sipas ligjit për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, cili nga institucionet e mëposhtëme është një organ qendror i administratës shtetërore:**

a. Instituti Pedagogjik i Kosovës.

b. Komuna e Prishtinës, përsa ka të bëjë me kompetencat në lëmin e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës.

c. Zyra e Kryeministrit.

d. Ministria e Administratës Publike.

**139. Sipas ligjit për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, cili nga institucionet e mëposhtëme është një organ qendror i administratës shtetërore:**

a. Komuna e Prishtinës

b. Zyra e Kryeministrit.

c. Enti i Statistikës së Kosovës.

d. Ministria e Administratës Publike.

**140. Sipas ligjit për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës cili nga institucionet e mëposhtëme është një organ i lartë i administratës shtetërore:**

a. Instituti Pedagogjik i Kosovës.

b. Enti i Statistikës së Kosovës.

c. Ministria e Administratës Publike.

d. Instituti i Kosovës për Administratën Publike.

**141. Organet e qendrore të administratës shtetërore, krijohen si rregull, për të ushtruar punë/përgjegjësi, të tipit:**

a. Hartim të politikave.

b. Detyra të natyrës përgatitore, këshilldhënëse ose shqyrtuese.

c. Përgatitje të ligjeve dhe akteve nënligjore.

d. Koordinimit të politikave qeveritare

**142. Organet lokale të administratës shtetërore janë:**

a. Organe të vetëqeverisjes lokale/vendore.

- b. Organe në varësi të një organi të lartë të administratës shtetërore apo një organi qëndror të administratës shtetërore.
- c. Organe në varësi të Komunave.
- d. Janë organe të pavarura të administratës shtetërore.

**143. Drejtoria e Bujqësisë që ushtron kompetencën në territorin e një apo disa komunave është:**

- a. Organ lokal i administratës shtetërore.
- b. Organ qendror i administratës shtetërore.
- c. Organ i lartë i administratës shtetërore.
- d. Organ në varësi të vetëqeverisjes vendore.

**144. Sipas ligjit për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, komponenti themelor i strukturës të një ministrie është:**

- a. Departamenti.
- b. Drejtoria
- c. Divizioni
- d. Zyra

**145. Nëpunësi më i lartë civil në një ministri është:**

- a. Drejtori i departamentit.
- b. Sekretari i Përgjithshëm.
- c. Ministri
- d. Zëvendësministri

**146. Cilë nga pohimet e mëposhtëme NUK është i sakte:**

- a. Ministri është drejtuesi politik i ministrisë.
- b. Ministri menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit e tjerë të ministrisë.
- c. Ministri është përgjegjës për zbatimin e politikave shtetërore në lëmin e veprimtarisë së ministrisë përkatëse.
- d. Ministri mban bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria.

**147. Cila nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Sekretari i Përgjithshëm menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit e tjerë të ministrisë.
- b. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë është drejtuesi politik i ministrisë.
- c. Sekretari i Përgjithshëm menaxhon financat dhe burimet e tjera të ministrisë.

- d. Sekretari i Përgjithshëm koordinon marrëdhëniet e ministrisë me organet e saj të vprimitarisë administrative.

**148. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Organet qendrore të administratës shtetërore organizohen në departamente dhe drejtorate.
- b. Organet qendrore të administratës shtetërore organizohen në drejtorate dhe sektorë.
- c. Organet qendrore të administratës shtetërore organizohen në departamente dhe divizione.
- d. Organet qendrore të administratës shtetërore organizohen në departamente dhe sektorë.

**149. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Avokati i Popullit është organ i pavarur i administratës shtetërore dhe i raporton Kuvendit të Kosovës.
- b. Avokati i Popullit është organ qendror i administratës shtetërore dhe i raporton Kuvendit të Kosovës.
- c. Avokati i Popullit është institucion i pavarur dhe i raporton Kuvendit të Kosovës.

**150. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Organet e pavarura të administratës shtetërore nuk i nënshtrohen mbikqyrjes nga ndonjë organ mbikqyrjeje;
- b. Organet e pavarura të administratës shtetërore, si rregull, i nënshtrohen mbikqyrjes sa ka të bëjë me ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre.
- c. Organet e pavarura të administratës shtetërore i nënshtrohen mbikqyrjes si cdo organ tjetër i administratës shtetërore;

**151. Sipas ligjit për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, komponenti themelor i strukturës të një organi qendror të administratës shtetërore është:**

- a. Departamenti.
- b. Drejtorati
- c. Sektori
- d. Divizioni

**152. Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj asaj lokale (komunave) janë marrëdhënie:**

- a. Varësie.
- b. Bashkëpunimi.
- c. Kontrolli dhe udhëheqje.

**153. Organet komunale janë:**

- a. Kuvendi i komunës dhe kryetari.
- b. Kuvendi i komunës dhe këshilli drejtues.
- c. Kuvendi i komunës dhe përfaqësuesi i qeverisë në komunë.
- d. Kuvendi i komunës dhe kryesia e kuvendit të komunës.

**154. Cila nga shprehjet e mëposhtëme është e saktë:**

- a. Kryetari i komunës është organi ekzekutiv i saj.
- b. Kryetari i komunës është organi përfaqësues i komunës.
- c. Kryetari i komunës është organi më i lartë i komunës.

**155. Cila nga shprehjet e mëposhtëme është e saktë:**

- a. Kuvendi i komunës është organi më i lartë i komunës.
- b. Kuvendi i komunës është përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës në nivel lokal.
- c. Kuvendi i komunës mbështet Kryetarin e Komunës në përfaqësimin e komunitetit lokal.

**156. Kryetari i komunës:**

- a. Zgjidhet nga Kuvendi i komunës.
- b. Zgjidhet me zgjedhje të drejpërdrejta lokale.
- c. Zgjidhet me vendim të qeverisë së RKS-së.

**157. Numri i komunave të Kosovës është:**

- a. 30
- b. 25
- c. 18
- d. 26

**158. Furnizimi i popullatës me ujë, ai i trajtimit të ujrave të zeza dhe ai i menaxhimit të mbeturinave, është:**

- a. Kompetencë (funktion) e Qeverisë së RKS.
- b. Kompetencë vetanake e komunave
- c. Kompetencë e qeverisë së RKS që i është deleguar komunave.
- d. Kompetencë e një organi të posaçëm të krijuar me ligj.

**159. Planifikimi urban dhe rural është:**



- a. Kompetencë vetanake e komunës përkatëse.
- b. Kompetencë (funktion) e Qeverisë së RKS.
- c. Kompetencë e qeverisë të RKS që i është deleguar komunave.
- d. Kompetencë e një organi të posaçëm të krijuar me ligj.

**160. Regjistrimi civil është:**

- a. Kompetencë vetanake e komunës përkatëse.
- b. Kompetencë (funktion) e Qeverisë së RKS.
- c. Kompetencë e qeverisë së RKS që i është deleguar komunave.

**161. Shqyrtimi administrativ i komunave është në kompetencën e:**

- a. Ministrisë përgjegjëse për qeverisjen lokale apo një ministri apo nje institucion tjetër i përcaktuar nga ligji.
- b. Çdo ministri për aktet e nxjerra në lëmin e saj të veprimtarisë.
- c. Qeveria e RKS-së.

**162. Shqyrtimi administrativ i komunave ushtrohet mbi:**

- a. Të gjitha aktet e Kuvendit dhe Kryetarit.
- b. Vetëm aktet me karakter të përgjithshëm të Kuvendit dhe Kryetarit.
- c. Çdo akt të kuvendit, Kryetarit dhe administratës komunale.

**163. Cili nga pohimet e mëposhtëme është më i sakti:**

- a. Shqyrtimi administrativ i komunave ushtrohet përpara hyrjes në fuqi të aktit.
- b. Shqyrtimi administrativ i komunave nuk pengon hyrjen në fuqi të aktit.
- c. Shqyrtimi administrativ i komunave pezullon hyrjen në fuqi të aktit

**164. Shqyrtimi administrativ i komunave për aktet në fushën e kompetencave vetanake përfshin:**

- a. Përputhshmërinë me politikat qeveritare.
- b. Përputhshmërinë me Kushtetutën dhe me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.
- c. Përshtatshmërinë e aktit.

**165. Shqyrtimi administrativ i komunave për aktet në fushën e kompetencave të deleguara përfshin:**

- a. Vetëm përputhshmërinë me kushtetutën.
- b. Vetëm përputhshmërinë me kushtetutën dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.
- c. Ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë.

166. Cili nga tatimet e mëposhtëme është tatim komunal:

- a. Tatimi mbi të ardhurat personale.
- b. Tatimi në pronën e paluajtshme.
- c. Tatimi mbi biznesin e vogël.
- d. Taksa administrative komunale.

167. Cili nga tatimet e mëposhtëm është tatim komunal:

- a. Tatimi mbi të ardhurat personale.
- b. Tatimi në të ardhurat e korporatës.
- c. Tatimi në pronën e paluajtshme.
- d. Tatimi mbi vlerën e shtuar.

168. Cila nga të ardhurat e mëposhtëme NUK mund të jetë e hyrë vetanake komunale:

- a. Të hyrat nga ndërmarrjet pjesërisht apo plotësisht në administrimin apo pronësinë e komunës.
- b. Të hyrat nga shitja e pasurive kombëtare që ndodhen në territorin e një komune të caktuar.
- c. Të ardhurat nga tatimi në pasurinë e paluajtshme.
- d. Taksat për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afarise.

169. Cila nga taksat e mëposhtëme NUK mund të jetë taksë komunale:

- a. Taksa për automjete motorike.
- b. Taksa administrative komunale.
- c. Taksa për lejet e ndërtimit dhe rrënimit të banesave.
- d. Taksa e televizionit publik.

170. Cila nga taksat e mëposhtëme NUK mund të jetë taksë komunale:

- a. Taksa për lejen për shërbimeve profesionale
- b. Taksa për lejen për shërbime afariste
- c. Tatimin mbi të ardhurat e korporatave
- d. Taksa për parkimin e automjeteve në pronën komunale.

171. **Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Komuna mund të marrë hua për investime kapitale dhe shpenzime operacionale.
- b. Komuna mund të marrë hua për çfarëdo lloj shpenzimi.
- c. Komuna mund të marrë hua vetëm për investime kapitale.
- d. Komuna mund të marrë hua vetëm për shpenzime operacionale.

172. **Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Komuna mund të marrë hua vetëm në tregun e brendshëm.
- b. Komuna mund të marrë hua në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar.
- c. Komuna mund të marrë hua vetëm në tregun e brendshëm dhe në monedhën jokombëtare.

173. **Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Komuna mund të marrë hua vetëm në tregun ndërkombëtar të kapitalit.
- b. Komuna mund të marrë hua vetëm në tregun kombëtar të kapitalit.
- c. Komuna mund të marrë hua në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.
- d. Komuna mund të marrë hua vetëm në tregun kombëtar të kapitalit në valutë të huaj.

174. **Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Kërkesa për marrjen hua nga një komunë, miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe autorizohet nga Ministria që mbulon lëmin e financave.
- b. Kërkesa për marrjen hua nga një komunë, miratohet nga Kryetari i Komunës dhe autorizohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- c. Kërkesa për marrjen hua nga një komunë, miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe autorizohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- d. Kërkesa për marrjen hua, nga një komune, miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe autorizohet nga Kuvendi i Kosovës.

## **Kreu 5: Pyetje mbi njohuritë e përgjithshme për BE-në, institutionet dhe ligjin European**

**175. Cili është Komuniteti i parë European i krijuar pas luftës së dytë botërore për të mbajtur nën një kontroll të përbashket industritë e lidhura me luftën:**

- a. Komuniteti European i Energjisë Atomike.
- b. Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut.
- c. Komuniteti European i Mbrojtjes.
- d. Komuniteti Ekonomik European.

**176. Mbi çfarë bazohet legjislacioni European**

- a. Traktatet.
- b. Kartën Europiane të të drejtave të Njeriut.
- c. Vendimet e Këshillit European.
- d. Vendimet e Komisionit European.

**177. Cili nga këto NUK është një institucion i Bashkimit European:**

- a. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
- b. Këshilli i Ministrave
- c. Komisioni European
- d. Parlamenti European

**178. Cili nga këto NUK është një institucion i Bashkimit European:**

- a. Gjykata Europiane e Drejtësisë.
- b. Komisioni European.
- c. Këshilli i Europës.
- d. Parlamenti European

**179. Cili nga këto NUK është një institucion i Bashkimit European:**

- a. Banka Qendrore Europiane.
- b. Komisioni European.
- c. Këshilli i Europës.
- d. Parlamenti European

**180. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Këshilli European përcakton drejtimit e përgjithshme politike dhe prioritet përkatëse në rrugën e integritit të BE-së.
- b. Këshilli European përbëhet nga Kryetarët e shteteve dhe/apo qeverive të vendeve anëtare, presidenti i tij dhe presidenti i Komisionit European.
- c. Këshilli European miraton legjislacionin European.
- d. Si rregull vendimarrja në Këshillin European bazohet në konsensusin e kryetarëve të shteteve dhe/apo qeverive përkatëse.

**181. Cili nga këto pohime është i saktë:**

- a. Parlamenti European përfaqëson parlamentet e shteteve anëtare të BE.
- b. Parlamenti European përfaqëson qytetarët e shteteve anëtare të BE.
- c. Parlamenti European përfaqëson qeveritë e shteteve anëtare të BE.
- d. Parlamenti European përfaqëson shtetet anëtare të BE-së.

**182. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Parlamenti European është pjese e ligjbërjes së BE-së dhe mbikqyr punën e Komisionit European.
- b. Parlamenti European përfaqëson parlamentet e shteteve anëtare në vendimarrjen Europiane.
- c. Parlamenti European kontrollon Gjykatën Europiane të Drejtësisë.
- d. Parlamenti European propozon ligjet Europiane.

**183. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë.**

- a. Anëtarët e Parlamentit European caktohen nga shtetet anëtare të BE-së.
- b. Anëtarët e Parlamentit European caktohen nga Parlamentet e shteteve anëtare të BE-së.
- c. Anëtarët e Parlamentit European zgjidhen nga zgjedhje direkte dhe të përgjithshme.
- d. Anëtarët e Parlamentit European zgjidhen nga anëtarët e Parlamenteve të shteteve anëtare.

**184. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Anëtarët e Parlamentit European (europarlamentarët) grupohen, kryesisht, në bazë të shtetit nga vijnë.
- b. Anëtarët e Parlamentit European (europarlamentarët) grupohen, kryesisht, në bazë të afinitetit të tyre politik.
- c. Anëtarët e Parlamentit European (europarlamentarët) grupohen, kryesisht, në bazë të delegacioneve europiane.
- d. Anëtarët e Parlamentit European (europarlamentarët) grupohen, kryesisht, në bazë të çështjeve që trajtojnë në Parlamentin European.

**185. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Komisioni European përbëhet nga 27 komisionere (përfshirë Presidentin dhe përfaqësuesin e lartë për çështjet e jashtme dhe politikat e sigurisë).
- b. Çdo shtet anëtar përfaqësohet sot në Komisionin European nga 1 komisioner.
- c. Shtetet anëtare përfaqësohen në Komision në mënyrë proporcionale.
- d. Komisioni drejtohet nga Presidenti i Komisionit.

**186. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Komisionerët përfaqësojnë shtetet anëtare të BE-së.
- b. Komisionerët përfaqësojnë qeveritë e shteteve anëtare të BE-së.
- c. Komisionerët janë të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre dhe përfaqësojnë vetëm interesat e BE-së në tërësinë e tij.
- d. Komisionerët përfaqësojnë grupet politike të Parlamentit European.

**187. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Komisionerët (e Komisionit European) janë të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre dhe nuk mund të marrin udhëzime nga shtetet anëtare.
- b. Komisionerët (e Komisionit European) marrin udhëzime nga qeveritë e shteteve anëtare të BE-së nga të cilat vijnë.
- c. Komisionerët (e Komisionit European) marrin udhëzime nga parlamentet e shteteve anëtare të BE-së nga të cilat vijnë.
- d. Komisionerët përfaqësojnë grupet politike të Parlamentit European.

**188. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë.**

- a. Komisioni European është forca tërheqëse e procesit të integritetit dhe rojtar i traktateve.
- b. Komisioni European miraton ligjet e Bashkimit European.
- c. Komisioni European përcakton drejtimet e përgjithshme politike dhe prioritetet përkatëse në rrugën e integritetit european.
- d. Komisioni European përfaqëson shtetet anëtare.

**189. Cili nga funksionet e mëposhtëm NUK i përket Komisionit European:**

- a. Propozimi i legjislativës europiane Parlamentit dhe Këshillit European.
- b. Miratimi i Buxhetit të BE-së.
- c. Menaxhimi dhe zbatimi i politikave dhe buxhetit të BE-së.

- d. Mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit European nën kontrollin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

**190. Cili nga funksionet e mëposhtëme NUK i përket Komisionit European:**

- a. Propozimi i legjislacionit european, Parlamentit dhe Këshillit European.
- b. Mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit European, nga shtetet anëtare nën kontrollin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë.
- c. Menaxhimi dhe zbatimi i politikave dhe buxhetit të BE-së.
- d. Përfaqësimi i Bashkimit European në fushën e politikës së jashtme të përbashkët dhe sigurisë.

**191. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Këshilli i Ministrave të BE-së është organi kryesor vendimarrës në sistemin institucional të BE-së.
- b. Këshilli i Ministrave të BE-së është forum i shprehjes dhe përfaqësimit të interesave të shteteve anëtare të BE-së.
- c. Këshilli i Ministrave të BE është institucion jashtë dhe mbi strukturën institucionale të BE-së.
- d. Këshillit të Ministrave të BE-së është organi i vetëm që ka iniciativë propozuese në formësimin e legjislacionit european.

**192. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i më i saktë:**

- a. Roli primar i Këshillit të Ministrave të BE-së (këshilli) është mbikqyrja e Komisionit European.
- b. Roli primar i Këshillit të Ministrave të BE-së (këshilli) është miratimi i legjislacionit european zakonisht së bashku me Parlamentin European.
- c. Roli primar i Këshillit të Ministrave të BE –së (këshilli) është menaxhimi dhe zbatimi i politikave të BE-së.
- d. Roli primar i Këshillit të Ministrave të BE-së (këshilli) është mbikqyrja e zbatimit të legjislacionit european nga shtetet anëtare.

**193. Cili nga pohimet e mëposhtëme NUK është i saktë:**

- a. Këshilli i Ministrave të BE –së (këshilli) përbëhet nga përfaqësues të shteteve anëtare në nivel ministrior.
- b. Çdo shtet anëtar përfaqësohet në Këshill me ministrin përgjegjës për fushën përkatëse të veprimtarisë.
- c. Këshilli i Ministrave të BE –së (këshilli) merr disa konfigurime të ndryshme në varësi të çështjeve që diskutohen në axhendë.

- d. Këshilli i Ministrave të BE-së (këshilli) përbëhet nga shefat e shteteve dhe/qeverive të shteteve anëtare të BE-se.

**194. Cila nga instancat e mëposhtëme NUK bën pjesë në sistemin gjyqësor të BE-së:**

- a. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European.
- b. Gjykata e Llogarive
- c. Tribunali i Shkallës së Parë.
- d. Tribunali për Shërbimin Civil.

**195. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Gjykata e Drejtësisë e BE-së ka për mision sigurimin e respektimit të së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e traktateve.
- b. Gjykata e Drejtësisë së BE-së është instanca e fundit e sistemeve gjyqësore të shteteve anëtare të BE-së.
- c. Gjykata e Drejtësisë së BE-së shqyrton në instance të fundit pas ezaurimit të rrugëve gjyqësore në nivel kombëtar, ankesave ndaj shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, nga shtetet anëtare.

**196. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Gjykata e Drejtësisë së BE-së gjykon nëse një shtet anëtar ka plotësuar detyrimet e legjislacionit europian apo ka dështuar në plotësimin e tyre.
- b. Gjykata e Drejtësisë së BE-së gjykon ligjshmerinë e akteve të institucioneve europiane.
- c. Gjykata e Drejtësisë së BE-së zgjidh në instancë të fundit konfliktet administrative të qytetarëve europiane ndaj veprimeve apo mosveprimeve të organeve administrative të shteteve anëtare.
- d. Gjykata e Drejtësisë së BE-së interpreton ligjin europian me kërkesë të instancave gjyqësore kombëtare të vendeve anëtare.

**197. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Tribunali për Shërbimin Civil i BE-së, gjykon mosmarrëveshjet ndërmjet funksionareve të BE-së dhe organeve të BE-së.
- b. Tribunali për Shërbimin Civil i BE-së, gjykon mosmarrëveshjet ndërmjet funksionarëve të administratave të shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve anëtare.
- c. Tribunali për Shërbimin Civil i BE-se, gjykon mosmarrëveshjet ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe institucioneve të BE-së.



- d. Tribunali për Shërbimin Civil i BE-së, gjykon mosmarrëveshjet në fushën e përputhshmërisë të legjislacioneve të shteteve anëtare të BE-së dhe legjislacionin European në këtë fushë.

**198. Cilat jane aktet dytësore te detyrueshme të legjislacionit european:**

- a. Rregulloret, vendimet dhe opinionet.
- b. Rregulloret, direktivat dhe vendimet.**
- c. Rregulloret, direktivat dhe qëndrimet.

**199. Parimi sipas te cilit, vendimarrja në BE duhet të merret sa më afër është e mundur qytetarit është:**

- a. Parimi i Demokracisë.
- b. Parimi i subsidiaritetit.**
- c. Parimi i proporcionalitetit.
- d. Parimi i i konferimit.

**200. Cila nga institucionet e mëposhtëme mbikqyr punën e komisionit:**

- 1. Gjykata Europiane e Drejtësisë.
- 2. Parlamenti European.**
- 3. Qeveritë e Shteteve anëtare.
- 4. Këshilli European.

**201. Ku u nënshkruar traktati që ndryshoj Komunitetin Ekonomik European në Bashkimin European:**

- a. Në Nicë.
- b. Në Amsterdam.
- c. Në Mastrit.**
- d. Në Romë

**202. Sa shtete anëtare ka sot Bashkimi European:**

- a. 25
- b. 24
- c. 27**
- d. 29

**203. Cili nga shtetet e mëposhtëm NUK është shtet anëtar i BE-së:**

- a. Anglia
- b. Zvicra**
- c. Finlanda
- d. Hollanda

**204. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Rregulloret, si instrumenti kryesor i legjisilacionit dytësor europian, janë të detyrueshme në tërësinë e tyre.
- b. Rregulloret, si instrumenti kryesor i legjisilacionit dytësor europian, kanë karakter normativ.
- c. Rregulloret, si instrumenti kryesor i legjisilacionit dytësor europian, kanë efekt direkt.
- d. Shtetet anëtare duhet ti transpozojnë pa vonesë rregulloret e miratuara nga BE në legjisilacionin e tyre të brendshëm.

**205. Cili nga pohimet e mëposhtëm NUK është i saktë:**

- a. Vendimet, si instrument i legjisilacionit dytësor europian, janë të detyrueshme për subjektet që u drejtohen.
- b. Vendimet, si instrument i legjisilacionit dytësor europian, kanë karakter normativ (janë akte që përcaktojnë rregulla të përgjithshme dhe abstrakte sjelljeje) dhe janë të detyrueshme.
- c. Vendimet, si instrument i legjisilacionit dytësor europian, mund ti drejtohen shteteve anëtare, individëve apo bizneseve të caktuara.

**206. Cili nga pohimet e mëposhtëm është më i saktë:**

- a. Direktivat, si instrument i legjisilacionit dytësor europian, janë të detyrueshme për subjektet të cilave u drejtohen.
- b. Direktivat, si instrument i legjisilacionit dytësor europian nuk mund të transpozohen në legjisilacionin kombëtar të shteteve anëtare.
- c. Direktivat, si instrument i legjisilacionit dytësor janë të detyrueshme për shtetet anëtare përsa i përket rezultatit që ato përcaktojnë se duhet arritur.
- d. Direktivat, si instrument i legjisilacionit dytësor kanë menjëherë efekt direkt.

**207. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë:**

- a. Koncepti i tregut të brendshëm mbështet në dy kolona kryesore: qarkullimin e lirë të faktorëve të prodhimit dhe konkurrencën e lirë.
- b. Koncepti i tregut të brendshëm mbështet në heqjen e vizave për lëvizjen e lirë të qytetarëve europiane.
- c. Koncepti i tregut të brendshëm mbështet në një politikë fiskale të përbashkët në shtetet anëtare të BE-së.

**208. Në cilin vit ra muri i Berlinit:**

- a. 1989
- b. 1990
- c. 1991
- d. 1992

**209. Cili nga komunitetet e mëposhtëme NUK ka qënë asnjëherë pjesë e komuniteteve europiane:**

- a. Komuniteti i European i Qymyrit dhe Çelikut.
- b. Komuniteti Ekonomik European
- c. Komuniteti European i Drejtave të Njeriut
- d. Komuniteti European i Energjisë Bërthamore.

**210. Cili nga komunitetet e mëposhtëme NUK ka qënë asnjëherë pjesë e komuniteteve europiane:**

- a. Komuniteti i European i Qymyrit dhe Çelikut.
- b. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë.
- c. Komuniteti Ekonomik European
- d. Komuniteti European i Energjisë Atomike.

**211. Cili nga elementet e mëposhtëme NUK ishte pjesë e Traktatit të Romës për Komunitetin Ekonomik European:**

- a. Bashkimi doganor
- b. Tregu i përbashkët
- c. Politika e perbashkët bujqësore.
- d. Politika e perbashkët e sigurisë

**212. Cili nga shtetet e mëposhtëme NUK ishte firmëtare e traktatit të Parisit për krijimin e Komunitetit European, në vitin 1951:**

- a. Franca
- b. Gjermani
- c. Anglia
- d. Italia

**213. Cili nga traktatet e mëposhtëme i nënshkruar në vitin 1992, shtoi në sistemin ekzistues european dy kolona të reja të quajtura: 1- politika e përbashkët dhe e jashtme dhe siguria dhe 2-bashkëpunimi në çështjet e brendshme dhe të drejtësisë?**

- a. Traktati i Mastritit.
- b. Traktati i Amsterdami.
- c. Traktati i Nisës.
- d. Traktati i Parisit.

**214. Në cilin vit monedha e përbashkët “Euro”hyri në qarkullim në 11 shtetet anëtare, që më pas u quajtën “zona Euro”?**

- a. 1990
- b. 1999
- c. 2002
- d. 2003

## Pjesa II. Aftësi të Përgjithshme: arsyetimi dhe të menduarit në mënyrë llogjike dhe analitike

### Kreu 1: Pyetje të llogjikës – matematikë bazike

215. Nëse 200 metra kablo optike kushton 240 Euro, sa do të kushtojnë 25 cm kablo optike?
- a. 1.2 euro
  - b. 1.3 euro
  - c. 0.3 euro
  - d. 3 euro
216. Cili nga numrat më poshtë është më i madh se  $\frac{1}{2}$ ?
- a.  $\frac{2}{5}$
  - b.  $\frac{4}{7}$
  - c.  $\frac{4}{9}$
  - d.  $\frac{5}{11}$
  - e.  $\frac{6}{13}$
217. Nëse një objekt zhvendoset me 5 metra në sekondë, sa metra mund të zhvendoset objekti në 1 orë:
- a. 30
  - b. 300
  - c. 720
  - d. 18000
218. Çdo pasticier mund të bëjë 2 torta të mëdha ose 35 torta të vogla në një orë. Pasticeria është e hapur për 2 orë dhe nevojiten të bëhen për një feste 20 torta të mëdha dhe 700 të vogla. Sa pasticierë nevojiten?
- a. 19
  - b. 15
  - c. 20
  - d. 25

219. Për dy vjet, im atë do të jetë saktësisht tre herë më i madh në moshë sesa jam unë tani. Im atë është 37 vjeç. Sa vjeç jam unë?
- a. 12
  - b. 13
  - c. 14
  - d. 15
220. Një roman i Ismail Kadarese mund të blihet, në një librari të Prishtinës për 20 Euro, në versionin me kapak lluksi dhe për 10 Euro në versionin si libër xhepi. I njëjti roman në versionin me kapak lluksi mund të blihet në internet me një ulje për 30% nga çmimi i kopertinës duke paguar 1 Euro shtesë për shpenzimet e speditimit. Sa më i madh është çmimi i romanit me kopertinë lluksi i blerë në internet nga çmimi i romanit si libër xhepi i blerë në librarinë e Prishtinës?
- a. 6 Euro
  - b. 3 Euro
  - c. 4 Euro
  - d. 5 Euro
221. Nëna e dërgoi Lirinë në dyqan për të marrë 9 kuti konservash me bizele. Liria mund të mbante vetëm dy kuti në një rrugë. Sa herë iu desh të shkonte në dyqan për t'i marrë të gjitha?
- a. 3
  - b. 4.5
  - c. 5
  - d. 5.5
222. Cili nga numrat më poshtë është i barabartë me 25%
- a.  $\frac{1}{25}$
  - b.  $\frac{1}{4}$
  - c.  $\frac{1}{3}$
  - d.  $\frac{1}{2}$
223. Dyshemeja e një dhome është në formë drejtkëndore dhe ka përmasat 4 x 5 metra. Dyshemeja është veshur me pllaka me përmasa 25 x 25 cm. Duke supozuar se të gjitha pllakat janë të plota, sa pllaka ka në dyshemenë e dhomës?
- a. 330
  - b. 430
  - c. 320
  - d. 500

224. Njëpunësi doli nga shtëpia në 07:15 për t'u ndodhur në zyrën e tij në Ministrinë e Financave në orën 08:00. Ai mbërriti në zyrë në orën 07:52. Sa minuta iu deshën atij për të mbërritur në zyrë?

- a. 35 minuta
- b. 37 minuta
- c. 45 minuta
- d. 47 minuta

225. Iliri ka një kartë debie, me overdraft me një interes ditor 0.5% për shumat në overdraft. Sa është shuma e interesit (në total) që do të paguajë Iliri për një shumë prej 250 euro në overdraft për një total prej 30 ditësh.

- a. 37.5
- b. 3.78
- c. 253.75
- d. 253.78

226. Arbeni ka në çantë 6 lapsa me ngjyra të ndryshme. Ai merr pa parë ngjyrat, vetëm dy lapsa. Sa kombinime të ndryshme të ngjyrave mund të ketë në dy lapsat e marrë nga Arbeni:

- a. 6
- b. 15
- c. 30
- d. 36

227. Vjosa mbështolli tabelën e saj me letër me ngjyrë. Tabela ishte 74 cm e gjerë dhe 44 cm e gjatë. Sa cm letër me ngjyrë iu nevojiti asaj për të mbështjellë tabelën?

- a. 236 cm<sup>2</sup>
- b. 592 cm<sup>2</sup>
- c. 3146 cm<sup>2</sup>
- d. 3256 cm<sup>2</sup>

228. Iliri po mblidhte të dhëna që të ndihmonte familjen e tij për të hartuar buxhetin. Ai kishte shënuar shpenzimet e tyre për ushqim për 4 javë rresht. Ata kishin shpenzuar 9.735 euro, 8.807 euro, 9.198 euro dhe 9.620 euro. Cila është mesatarja e shpenzimit të tyre për ushqim për 4 javë?

- a. 9.003 euro

- b. 9.271 euro
- b. 9.340 euro
- c. 9.406 euro

229. Tavani i një dyqani në formë drejtkëndëshi ka përmasat 12 x 18 m dhe është veshur me panela katrore 1x1m. Secili panel peshon çerek kilogrami. Sa është pesha totale e paneleve të përdorur për veshjen e tavanit?

- a. 36 kg
- b. 54 kg
- c. 121 kg
- d. 216 kg

230. Një motoçikletë përshkoi 180 km për 5 orë. Cila ishte shpejtësia mesatare e lëvizjes?

- a. 18 km
- b. 30 km
- c. 36 km
- d. 38 km

231. Koha e reagimit për 5 telefonata për ndihmë që mori një punonjës i shërbimit zjarrefikës ishin 38 minuta, 2 minuta, 32 minuta, 8 minuta dhe 25 minuta. Cila ishte koha mesatare e reagimit?

- a. 2 minuta
- b. 21 minuta
- c. 38 minuta
- d. 105 minuta

232. Iliri ka 2000 aksione me një vlerë tregu prej 4.8 Euro secili. Vitin e fundit ai përfitoi një dividend prej 240 Euro. Sa është përqindja vjetore e fitimit për aksion?

- a. 0.025%
- b. 2%
- c. 2.5%
- d. 40%

233. Vjosa procesoi 300 kërkesa për licence gjatë muajit Qershor. Gjatë muajit Korrik ajo procesoi 10% kërkesa për licencë më pak. Sa kërkesa për licencë procesoi ajo gjatë muajit korrik?

- a. 220
- b. 240
- c. 270



d. 280

234. Shkolla “Edit Durham” ka pasur një buxhet 9 herë më të madh se shkolla “Bajram Curri”. Nëse buxheti vjetor i të dyja shkollave së bashku është 1,000,000 Euro, sa është mesatarisht buxheti mujor i shkollës “Bajram Curri”?

a. 8,111.00

a. 8,222.22

b. 8,333.33

c. 8,444.44

235. Koha e parashikuar për zhvillimin e një testi me 100 pyetje është 3 ore e  $\frac{1}{3}$ . Dhjetë (10) aplikantë morën testin dhe e përfunduan për 3 orë. Sa është diferenca mesatare ndërmjet kohës së 10 aplikantëve dhe kohës së parashikuar për zhvillimin e një testi për çdo pyetje?

a. 10 sekonda për çdo pyetje

b. 12 sekonda për çdo pyetje

c. 14 sekonda për çdo pyetje

d. 16 sekonda për çdo pyetje

236. Nëse ora e New York është tre orë para orës së San Franciskos, sa është ora në New York nëse një sahat në San Francisco është një orë mbrapa dhe tregon pikërisht orën 4?

a. 1

b. 6

c. 7

d. 8

237. Në vitin 2011, një kompani shiti 730,000 njësi të produktit të saj të vetëm. Volumi i vjetor i shitjes të këtij produkti në vitin 2011 ishte 50% të volumit të shitjes të të njëjtit produkt në vitin 2010. Sa ishte volumi ditor i shitjes të produktit në vitin 2010 (viti 2010 ka 365 ditë).

a. 5,000 njësi.

b. 4,000 njësi.

c. 2,000 njësi

d. 1,100 njësi.

238. Një nëpunës voziti nga Prishtina për të marrë pjesë në një seminar pune në Durrës. Distanca totale për udhëtimin vajtje-ardhje ishte 240 km. Koha e vozitjes nga Prishtina në Durrës në vajtje është 2 orë. Në kthim për shkak të trafikut u nevojiti një orë më shumë. Mesatarisht sa më avash ka udhëtuar nëpunësi në kthimin për në Prishtinë sesa në vajtje?

a. 15 km/orë më avash

- b. 35 km/orë më avash
- c. 40 km/orë më avash
- d. 80 km/orë më avash

**239. Një makineri prodhon 200 njësi produkti në minutë. Nëse në një kuti paktohen 25 njësi produkti, sa kuti mund të mbushen me produktin e prodhura nga makina në një orë?**

- a. 125
- b. 480
- c. 500
- d. 2,500

**240. Dy kamiona kryejnë një udhëtim me gjatësi 1680 km. Kamioni i parë bën mesatarisht 14 km me një litër karburant dhe i dyti 12 km me një litër karburant. Sa litra karburant më shumë u konsumuan nga kamioni i dytë në krahasim me kamionin e parë?**

- a. 10
- b. 20
- c. 30
- d. nuk është e mundur të gjendet rezultati me të dhënat më sipër.

**241. Ashensori i një qendre tregtare ndalon në secilin nga katet e ndërtesës. Nëse lartësia e një kati është 5 metra dhe ashensori udhëton me shpejtësi të barabarte me 7.5 metra në sekondë, sa është përafërsisht koha e nevojshme për të arritur në katin e 68 të ndërtesës.**

- a. 2 sekonda
- b. 9 sekonda
- c. 38 sekonda
- d. 45 sekonda
- e. 510 sekonda

**242. Një anije kontenier udhëton me një shpejtësi mesatare 25 km/orë dhe kryen 500 km nga porti A në portin B. Gjatë udhëtimit të kthimit nga porti B në portin A, anija udhëton me shpejtësi mesatare 15 km/orë. Sa është përafërsisht diferenca në kohë ndërmjet dy udhëtimeve:**

- a. 12.5 orë
- b. 13.3 orë
- c. 26.7 orë
- d. 33.3 orë

243. Në muajin Janar numri i punonjësve në një ndërmarrje shtetërore u ul me 8%. Në muajin Korrik, menjëherë pas zgjedhjeve, numri i punonjësve në të njejtën ndërmarrje u rrit me 8%. Numri total i punonjësve përpara reduktimit të Janarit ishte 326. Sa ishte, përafërsisht, numri i punonjësve të ndërmarrjes mbas rritjes në Korrik?
- a. 307
  - b. 318
  - c. 324
  - d. 326
244. Nëse në një klasë me 78 nxënës, 41 janë regjistruar në lëndën e gjuhës franceze dhe 22 në atë të gjuhës gjermane, sa nxënës nuk janë regjistruar në asnjë gjuhë të huaj, nëse 9 nga studentet janë regjistruar në lëndën e gjuhës franceze dhe gjermane njëkohësisht.
- a. 6
  - b. 15
  - c. 24
  - d. 33
245. Nëse gjatë një semestri një nxënës ka marrë në gjashtë provime, përkatësisht 76, 80, 83, 71, 80 dhe 78 pikë, cila është mesatarja e nxënësit?
- a. 76
  - b. 77
  - c. 78
  - d. 79

## Kreu 2: Pyetje të llogjikës - numerike<sup>1</sup>

246. Shikoni këtë seri numrash: 2, 1,  $\frac{1}{2}$ ,  $\frac{1}{4}$ , .....Cili do të jetë numri që vjen më pas?.
- a.  $\frac{1}{3}$
  - b.  $\frac{1}{8}$
  - c.  $\frac{2}{8}$
  - d.  $\frac{1}{16}$
247. Shikoni këtë seri numrash: 7, 10, 8, 11, 9, 12, .... Cili do të jetë numri që vjen më pas?.
- a. 7
  - b. 10
  - c. 12
  - d. 13
248. Shikoni këtë seri numrash: 36, 34, 30, 28, 24, .... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 20
  - b. 22
  - c. 23
  - d. 26
249. Shikoni këtë seri numrash: 22, 21, 23, 22, 24, 23,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 22.
  - b. 26
  - c. 25
  - d. 27
250. Shikoni këtë seri numrash: 53, 53, 40, 40, 27, 27,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 12.
  - b. 14.
  - c. 27.
  - d. 53.

---

<sup>1</sup> Udhëzim për zgjidhjen me sukses të këtyre pyetjeve: : në çdo seri numrash, shikoni për shkallën dhe drejtimin e ndryshimit ndërmjet numrave. Me fjalë të tjera nëse numrat rriten apo zvogëlohen dhe konkretisht me sa rriten apo zvogëlohen.

251. Shikoni këtë seri numrash: 21, 9, 21, 11, 21, 13, 21,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 14.
  - b. 15.
  - c. 21.
  - d. 23.
252. Shikoni këtë seri numrash: 58, 52, 46, 40, 34, .... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 26.
  - b. 28.
  - c. 30.
  - d. 32.
253. Shikoni këtë seri numrash: 3, 4, 7, 8, 11, 12,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 7.
  - b. 10.
  - c. 14.
  - d. 15.
254. Shikoni këtë seri numrash: 8, 22, 8, 28, 8,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 9.
  - b. 29.
  - c. 32.
  - d. 34.
255. Shikoni këtë seri numrash: 31, 29, 24, 22, 17, .... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 15.
  - b. 14.
  - c. 13.
  - d. 12.
256. Shikoni këtë seri numrash: 80, 10, 70, 15, 60,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 20.
  - b. 25.
  - c. 30.
  - d. 50.

257. Shikoni këtë seri numrash: 2, 6, 18, 54,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 108.
  - b. 148.
  - c. 162.
  - d. 216.
258. Shikoni këtë seri numrash: 1000, 200, 40,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 8.
  - b. 10.
  - c. 15.
  - d. 20.
259. Shikoni këtë seri numrash: 544, 509, 474, 439, .... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 404.
  - b. 414.
  - c. 420.
  - d. 445.
260. Shikoni këtë seri numrash: 2, 4, 6, 8, 10,.... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 11.
  - b. 12.
  - c. 13.
  - d. 14.
261. Shikoni këtë seri numrash: 201, 202, 204, 207, .... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 205.
  - b. 208.
  - c. 210.
  - d. 211.
262. Shikoni këtë seri numrash: 14, 28, 20, 40, 32, 64,..... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 52.
  - b. 56.
  - c. 96.
  - d. 128.

263. Shikoni këtë seri numrash: 1.5, 2.3, 3.1, 3.9, ..... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 4.2.
  - b. 4.4.
  - c. 4.7.
  - d. 5.1.
264. Shikoni këtë seri numrash: 5.2, 4.8, 4.4, 4,..... Cili do të jetë numri që vjen më pas?
- a. 3.
  - b. 3.3.
  - c. 3.5.
  - d. 3.6.
265. Shikoni seritë e numrave: 664, 332, 340, 170, \_\_\_\_, 89,..... Cili numër mungon?:
- a. 85.
  - b. 97.
  - c. 109.
  - d. 178.
266. Shikoni seritë e numrave: F2, \_\_, D8, C16, B32,..... Cili numër apo cili numër dhe cila shkronjë mungon?:
- a. A16.
  - b. G4.
  - c. E4.
  - d. E3.
267. Shikoni seritë e numrave: 70, 71, 76, \_\_, 81, 86, 70, 91, 96.....: Cili numër mungon?:
- a. 70.
  - b. 71.
  - c. 80.
  - d. 96.
268. Shikoni seritë e numrave: 8, 43, 11, 41, \_\_, 39, 17, .....: Cili numër mungon?:
- a. 8.
  - b. 14.
  - c. 43.
  - d. 44.

269. Shikoni seritë e numrave: 83, 73, 93, 63, \_\_, 93, 43, ..... Cili numër mungon:
- a. 33.
  - b. 53.
  - c. 73.
  - d. 93.
270. Shikoni seritë e numrave: 15, \_\_, 27, 27, 39, 39, ..... Cili numër mungon?:
- a. 51.
  - b. 39.
  - c. 23.
  - d. 15.
271. Shikoni seritë e numrave: 72, 76, 73, 77, 74, \_\_, 75, ..... Cili numër mungon?:
- a. 70.
  - b. 71.
  - c. 75.
  - d. 78.
272. Shikoni seritë e numrave: 0.15, 0.3, \_\_\_\_, 1.2, 2.4, ..... Cili numër mungon?:
- a. 4.8.
  - b. 0.006.
  - c. 0.6.
  - d. 0.9.
273. Shikoni seritë e numrave: 4, 7, 25, 10, \_\_, 20, 16, 19, ..... Cili numër mungon?:
- a. 13.
  - b. 15.
  - c. 20.
  - d. 28.
274. Shikoni seritë e numrave:  $(1/9)$ ,  $(1/3)$ , 1, \_\_\_\_, 9, .....: Cili numër mungon?:
- a.  $(2/3)$ .
  - b. 3.
  - c. 6.
  - d. 27.



275. Shikoni seritë e numrave: VI, 10, V, 11, \_\_, 12, III,.....: Cili numër apo cili numër dhe cila shkronjë mungon:

- a. II.
- b. IV.
- c. IX.
- d. 14.

### Kreu 3: Pyetje të llogjikës – arsyetuese, deduksionit dhe të aftësive për zgjidhjen e problemeve

276. Faktet: Zyra e Vjosës është dy kate mbi zyrën e Valdetes. Zyra e Valdetes është 1 kat më poshtë zyrës të gruas së vetme në ndërtesë që ka datëlindjen sot. Zyra e Sarandës është në katin e tretë, ndërsa zyra e Vjosës është në katin e katërt. Konkluzioni: Sot Vjosa ka datëlindjen. **Cila nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:**

- a. Faktet e mësipërme e konfirmojnë konkluzionin.
- b. Faktet e mësipërme nuk e konfirmojnë konkluzionin.
- c. Faktet e mësipërme as nuk e konfirmojnë as nuk e hedhin poshtë konkluzionin.

277. Pjesa më e madhe e familjes Hoxha, jetojnë në Suharekë. Shumë banorë të Suarekës e festojnë festën e Bajramit. Mehdiu është një nga anëtarët e familjes Hoxha. **Bazuar në këto fakte ne mund të arrijmë, me siguri, në konkluzionin se:**

- a. Mediu jeton në Suharekë.
- b. Mediu nuk e feston festën e Bajramit
- c. Të gjithë Hoxhat e festojnë festën e Bajramit.
- d. Asnjë nga pohimet e mësipërme.

278. Dritani duhet të vozitë nëpërmjet Austostradës së re për të shkuar në punë. Dritani ka sot në orën 9.00 një takim të rëndësishëm. Nëse Dritani nuk arrin në takimin e orës 9.00 ai mund të humbë rastin për lidhjen e një kontrate të rëndësishme. Autostratada e re është e mbyllur sot përgjatë gjithë dites për shkak të riparimeve të nevojshme në rrugë. **Bazuar nga sa më sipër, ne mund të arrijmë në konkluzionin se:**

- a. Dritani nuk do të jetë në gjendje të shkojë në punë.
- b. Dritani ndoshta nuk do të mund të caktojë një orë tjetër për takimin e rëndësishëm.
- c. Dritani do të humbë kontratën në fjalë
- d. Asnjë prej pohimeve të mësipërme.

279. Vjosa raportoi në polici se dje vonë, ndërsa ishte në lift, duke zbritur nga zyra, në katin e 15 të ndërtesës së ministrisë, një burrë që kishte hipur në lift në katin e 12, i kishte rëmbyer celularin. Ajo i tha policisë, gjithashtu, se kishte përshtypjen se burrin në fjalë e kishte parë edhe më përpara në ndërtesën e ministrisë. Studio përshkrimin e mëposhtëm që Vjosa i bëri policisë

për burrin në fjalë. **Cili nga përshkrimet e mëposhtëme të Vjosës, do të ishte më i dobishëm për të gjetur burrin në fjalë, nëse supozohet se ai punon në ndërtesën e ministrit:**

- a. Atij i vinte erë goja.
- b. Ai mbante një kravatë të verdhë.
- c. Ai kishte një nishan të madh në ballë.
- d. Ai mbante një dosje të kuqe.

280. Kyeinspektori i sigurisë ushqimore që mbulon territorin e komunës së Prishtinës, përpaket të kryejë një shërbim cilësor për sigurinë ushqimore të qytetarëve të Prishtinës, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të përdorë burimet financiare në dispozicion në mënyrë eficiente. Kështu Kyeinspektori duhet të marrë në konsideratë disa faktorë kur përdor burimet në dispozicion. Psh. nëse është pushimi i fund javës, inspektorët shtesë duhet të dalin në punë. Sidoqoftë nëse inspektorët shtesë dalin në punë në fundjavë, është e nevojshme që çdo herë të kërkohet paraprakisht autorizim nga ministria për shkak të pagesës të orëve jashtë orarit. **Bazuar nga sa më sipër, ne mund të arrijmë në konkluzionin se:**

- a. nëse është pushimi i fund javës, nuk është e nevojshme të kërkohet autorizim nga ministria.
- b. nëse nuk është pushimi i fund javës, është nevojshme të kërkohet autorizim nga ministria.
- c. nëse nuk kërkohet autorizim nga ministria atëherë nuk është pushimi i fund javës.
- d. nëse autorizimi nga ministria nuk është i nevojshëm, atëherë është pushimi i fund javës.

281. Iliri po përpaket të gjejë një vend të përshtatshëm për të hapur një dyqan lodrash në qytetin e Pejës. Ai po kërkon një vend që është tamam në qendër të qytetit ose jo larg saj dhe që do të tërhiqte blerës që bëjnë shopping në këmbë. **Cila nga vendet e mëposhtme do të ishte më i përshtatshmi, për dyqanin e Ilirit, sipas kërkesave të mësipërme:**

- a. një dyqan i vogël tre blloqe nga bulevardi kryesor i Pejës, që gjendet përballë një shkolle fillore dhe pranë një dyqani që shet ëmbëlsira.
- b. një dyqan i veçuar në buzë të një rruge rezidenciale që ndodhet rreth 5 blloqe nga bulevardi kryesor i Pejës.

- c. një dyqan luksoz në një ndërtesë të sapo inaguruar shumë afër qendrës të qytetit ngjitur me stacionin e trenit, ku kryesisht udhëtojnë të rinjtë dhe profesionistët pa fëmijë që udhëtojnë drejt Prishtinës për çdo ditë.
- d. Një dyqan në një qendër tregtare të vogël që gjendet në periferinë e qytetit dhe që në pjesën më të madhe ka dyqane që tregtojnë pjesë këmbimi për makina.

**282.** Doktor Sala, ka një klinikë dentare pediatrike (për fëmijë) dhe ka nevojë për një higjenist të aftë dhe të besueshëm për ta ndihmuar në klinikën e tij. Dy personat e fundit që punësoj i ishin rekomanduar nga disa kolegët e tij dentistë, por secili nuk zgjati më shumë se një muaj në punë.

**Cilën nga kandidatët e mëposhtëm duhet të punësojë doktor Sala:**

- a. Saranda që ka qenë higjeniste për 15 vjet dhe për të cilën punëdhënësi i tanishëm i së cilës është në prag të pensionimit, thotë që është më e mira në treg. Klientela për të cilën ajo ka punuar përbëhet nga njerëzit më të pasur të qytetit.
- b. Vjosa që sapo është diplomuar në një nga programet më të mira të Kosovës për higjenist dentar. Vjosa përpara se të bëhej higjenist dentar ka punuar për rreth dy vjet në një qendër ditore për fëmijët.
- c. Ademi që ka punuar si higjenist dentar, për tre vjet në një klinikë shtetërore shëndetësore. Ademi është shumë i interesuar të fillojë një punë në klinikë dentare private.
- d. Fitojra që është një higjeniste dentare me eksperiencë dhe shumë e rekomanduar dhe që gjithashtu po perfundon studimet për arsimtare parashkollore, që shpreson ta ndihmojë për të gjetur një punë si edukatore kopshti, pasi ka dashur gjithmonë të punojë me fëmijët.

**283.** Vjosa, një pasticieri me eksperiencë që është e njohur për tortat e saj të mrekullueshme dhe me pamje artistike dhe e specializuar në bërjen e tortave për dasma, datëlindjes dhe ceremoni të tjera festive, ka hapur një dyqan të vogël rreth një vit më parë dhe për çudi biznesi i ka ecur keq. Djali i axhës së saj që është dhe konsulent marketingu, kreu një kërkim tregu dhe doli në konkluzionin se banorët përreth nuk e mendonin dyqanin e saj si një dyqan që mund të vizitohej çdo ditë, por më shumë si një dyqan i cili duhej të vizitohej në rastet të veçanta të ceremonive festive. **Cilën nga strategjitë e mëposhtëme mendoni se duhet të zgjedhë Vjosa për të rritur biznesin e saj:**

- a. të shpërndajë karta anëtarësie për klientët, nëpërmjet të cilave mbajtësi të kishte një ulje 20% në raste të tortave të ceremonive apo të datëlindjeve.

- b. të merrte pjesë në panairin e qytetit dhe të ekspozonte tortat e saj për tu shijuar.
- c. të vendoste lajmërime në gazetatat lokale ku të tregonte llojet e ndryshme të tortave që ajo përgatiste në dyqanin e saj.
- d. Të ndryshonte dyqanin në një lagje tjetër të qytetit.

284. “Inspektorati fito-sanitar i Kosovës, është i alokuar në Prishtinë dhe përbëhet nga 15 grupe të lëvizshme të inspektimit fito sanitar të Republikës. Pjesa më e madhe e grupeve të inspektorëve kryejnë inspektime në pikat e kalimit të kufirit të Kosovës. Disa grupe inspektimi kryejnë inspektime në qendrat e mëdha urbane larg prej pikave të kalimit të kufirit.”

**Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se:**

- a. Pjesa më e madhe e grupeve të inspektimit kryejnë detyrë larg pikave të kalimit të kufirit.
- b. Asnjëri nga grupet e inspektimit nuk është i përjashtuar nga kryerja e detyrës në seicilin nga vendet ku është e nevojshme.
- c. Grupet e inspektimit që kryejnë detyrën në qendrat e mëdhaja urbane nuk është e nevojshme të lëvizin në pjesë të tjera të vendit.
- d. Pak grupe inspektimi kryejnë detyrën në pikat e kalimit të kufirit.

285. Gjatë 6 viteve të fundit numri i doktorëve është rritur me rreth 20%. Gjatë të njejtës periudhë, numri i menaxherëve në sistemin shëndetësor është rritur me 600%. Këto përqindje tregojnë se shumë doktorë kanë humbur pushtetin për të përcaktuar oraret e tyre të operacioneve dhe vizitave, të përcaktojnë çmimet e këtyre dhe të vendosin mbi recetat që japin.

**Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se doktorët:**

- a. janë të indinjuar me ndërhyrjen e menaxherëve.
- b. nuk kanë më trajnimin e duhur.
- c. kujdesen më shumë për pacientët e tyre.
- d. janë më pak të pavarur se ç’ishin më përpara.
- e. po bëjnë më pak pare se ç’benin më përpara.

286. Konsumimi i drogave nga njerëzit mund të parandalohet jo vetëm duke ndaluar shitjen e tyre në treg, por gjithashtu edhe duke udhëzuar përdoruesit mbi efektin e rrezikshëm që ato duhet të kuptojnë për sigurinë e tyre. Gjithashtu për ata që kanë varësi nga drogat mund të sigurohet

trajtimi për rehabilitim në qendrat e specializuara mjeksore. Kjo do të ndihmojë në uljen e përdorimit të drogave.

**Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se konsumi i drogave të dëmshme:**

- a. po rritet në shoqërinë sotme.
- b. mundet gjithmonë të reduktohet.
- c. është për shkak të mungesës së qendrave mjeksore.
- d. mund të eliminohet duke ndaluar shitjen e tyre.
- e. mund të reduktohet nëpërmjet sistemeve të përshtatshme.

**287.** Rasimi është me i madh se kushëriri i tij Azemi. Vëllai i Azemit, Arditi është më i madh se Rasimi. Kur Azemi dhe Arditi shkojnë për vizitë në shtëpinë e kushëririt ata luajnë të tre së bashku me letra. Azemi fiton më shpesh se Rasimi.

**Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se.**

- a. kur luan me letra me Azemin dhe Rasimin, Arditi shpesh humbet.
- b. nga të tre Rasimi është më i madhi.
- c. Rasimi mërzhitet kur humbet në lojën me letra.
- d. nga të tre, Azemi është më i vogli.

**288.** Sot nxënësit e shkollës së mesme, shpenzojnë shumë kohë duke u marrë me gjëra të parëndësishme dhe që i tërheqin vëmendjen nga shkolla si psh. me modën e të veshurit. Për më shumë ata vishen në ambientet e shkollës në mënyrë të papërshtatshme. Ministria e Arsimit mendon se më mirë se të përcaktojnë rregulla të detyruara për veshjen duhet ta bëjë uniformën shkollore të detyrueshme. Nëse nxënësve do t'iu kërkohet të vishnin uniformë, kjo do të rriste sensin e komunitetit dhe harmonisë në shkollë dhe do të nxiste një ndjenjë disipline tek ata. Një pasojë tjetër pozitive do të ishte që mësuesit dhe drejtoritë e shkollave nuk do të duhet të vepronin më si policë të rregullave të veshjes, duke i lënë më shumë kohë për tu marrë me gjëra të tjera më të rëndësishme.

**Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se.**

- a. Veshja e papërshtatshme çon në nota më të ulëta.
- b. Nxënësit që veshin uniformën shkojnë në univeristet.
- c. Uniformat duhet të jenë të detyrueshme për nxënësit e shkollave të mesme.
- d. Mësuesit dhe drejtoritë shpenzonte të paktën 25% të kohës duke u marrë me zbatimin e rregullave të veshjes nga nxënësit.

289. Obeziteti po kthehet në një problem serioz në Kosovë. Kërkimet sugjerojnë që obeziteti mund të çojë në një numër problemesh shëndetësore që përfshijnë, diabetin, sëmundjet e zemrës dhe azmën. Studimet e fundit tregojnë gjithashtu se mund të ketë një lidhje ndërmjet obezitetit dhe disa forma të tumoreve. Fushat shëndetësore, që risin ndërgjegjësimin e publikut dhe propozojnë ndryshime në stilin e jetesës, që nese ka vullnet dhe dëshirë, të eliminojnë apo të paktën ulin incidencën e obezitetit janë një hap i parë thelbësor në luftën ndaj këtij problemi me të vërtetë kritik.

**Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se.**

- a. Fushat shëndetësore, që risin ndërgjegjësimin e publikut dhe propozojnë ndryshime në stilin e jetesës, janë një mënyrë produktive për të luftuar obezitetin.
- b. Obeziteti është shkaku kryesor i sëmundjes të diabetit në Kosovë.
- c. Njerëzit në Kosovë shikojnë shumë television dhe nuk bëjnë ushtrime fizike.
- d. Një ulje e obezitetit do ulte në mënyrë thelbësore azmën.
- e. Fastfood-et kontribuojnë në rritjen e obezitetit.

290. Vjosa ka qenë për një vizitë te shokët e saj të Universitetit në Tiranë gjatë 3 javëve të fundit. Ajo do të largohet nesër dhe avioni niset shumë herët në mëngjes. Pjesa më e madhe e shoqeve të saj banojnë në afërsi të aeroportit “Nënë Tereza”. Drita banon 10 km larg aeroportit, Flavia banon 5 km larg ndërsa Sabina 7 km larg. Arditi banon pak më larg se Flavia, por më afër nga aeroporti se Sabina. **Afërisht sa larg aeroportit banon Arditi?**

- a. nëntë km
- b. shtatë km
- c. tetë km
- d. gjashtë km.

291. Neni x i Kushtetutës së Kosovës, mbron qytetarët kundër kontrollit të banesës dhe sendeve personale. Asnjë kontroll i banesës apo sendeve personale, nuk mund të kryhet pa pasur një mandat të shkruar kontrolli të lëshuar për çështjen në fjalë. Kjo do të thotë që një gjykatës i pavarur, duhet të miratojë dhe bazat faktike që justifikojnë kontrollin përpara se ai te kryhet.

**Bazuar në paragrafin më sipër, konkluzioni më i saktë që do të mund të arrihej është se policia nuk mund të kontrollojë banesat apo sendet personale të qytetarëve pa patur:**

- a. një autorizim të ligjshëm.
- b. prova direkte për një krim.

- c. një dyshim të arsyshëm se është kryer një krim.
- d. prezencën e një gjykatësi.

292. Nadirja, po planifikon të organizojë një darkë për datëlindjen e 35-të të bashkëshortit të saj. Ajo dëshiron që darka të jetë e paharrueshme, por bashkëshorti është një njeri i thjeshtë që preferon zakonisht të vishet me xhinse dhe të shikojë një ndeshje futbolli.

**Bazuar në paragrafin më sipër, cilin restorant do të zgjidhte Nadirja:**

- a. një restorant në qendër të Prishtinës që ofron guzhinë Italiane dhe një dekor elegant të rilindjes Italiane, ku do të ndiheshin sikur e kaluan mbrëmjen në një vilë Italiane luksi.
- b. në restorantin “Route 66”, që ofron një kuzhine të tipit bufe, ku mund të hash sa të mundesh me një çmim fiks dhe ku bëhen *tacos* më të mira të qytetit.
- c. Në një restorant Francez me 4 yje, ku klientët trajtohen si të ishin mbretër dhe që do të ishte një eksperiencë e paharueshme.
- d. te Restoranti “Fitorja”, ku ofrohen pjata të mrekullueshme në një ambient të organizuar si një klub futbolli, në nder të pronarit, një futbollist i famshëm i “Fitores”.

293. Vitin e fundit, nxënësit e shkollave të mesme publike të qytetit të Gjakovës dolën më keq në provimin e maturës se nxënësit e shkollave të mesme publike të Prishtinës. Vitet e fundit, gjithmonë e më shumë banorët e Gjakovës po i çojnë fëmijët në shkollat e mesme private, ku raporti mësues-nxënës është tradicionalisht më i ulët sesa në shkollat publike dhe për pasojë numri i regjistrimeve në shkollat publike të Gjakovës po ulet gradualisht.

**Bazuar në paragrafin më sipër, nëse do të ishit prindër në qytetin e Gjakovës dhe do të ishit të shqetësuar për të ardhmen në arsimimin e fëmijëve tuaj, cilën nga alternativat e mëposhtëme do të zgjidhnit.**

- a. Do të regjistroni fëmijët në një nga shkollat e mesme publike të Gjakovës.
- b. Do të vazhdonit të qendronit në Gjakovë dhe do të regjistronit fëmijët në një shkollë të mesme private.
- c. Zhvendoseni nga Gjakova dhe regjistroni fëmijët në një shkollë private.
- d. Zhvendoseni në Prishtinë dhe regjistroni fëmijët në shkollat publike të Prishtinës.

294. Është fakt që kostoja e qerasë është komponenti i dytë më i madh i shpenzimeve të jetesës për banorët e Prishtinës. Vitet e fundit kostoja e qerasë në pjesën veriore të qytetit është më e



lartë se në pjesën perëndimore të qytetit, por më e ulët se në pjesën lindore të tij. Kostoja e jetesës në pjesën veriore të qytetit është më e lartë se kostoja e jetesës në pjesën lindore të tij.

**Bazuar në paragrafin më sipër, cila nga pohimet e mëposhtëme është gjithashtu, me siguri i vërtetë.**

- a. kostoja e qerasë në pjesën lindore është më e madhe se në pjesën perëndimore.
- b. kostoja e jetesës në pjesën veriore është më e madhe se në pjesën perëndimore.
- c. kostoja e qerasë në pjesën lindore është më e vogël se në pjesën veriore.
- d. kostoja e qerasë është më e lartë në pjesën perëndimore sesa në pjesën lindore.

295. Të dhënat e kultivuesve të lakres të Kosovës për vitin 2011, tregojnë që: 80% të lakrave të mbledhura ishin të renda (mbi 05.kg), 20% ishin jeshile, 60% ishin me ngjyrë të kuqe dhe 50 % ishin të mëdha (me diametër mbi 10 cm).

**Bazuar në paragrafin më sipër, cili nga pohimet e mëposhtëme NUK nuk mund të jetë i saktë:**

- a. të gjitha lakrat e kuqe nuk ishin të mëdha,
- b. 30% të lakrave të kuqe ishin të mëdha
- c. nuk kishte lakra që ishin njëkohësisht jeshile dhe të mëdha
- d. gjysma e lakrave ishin të vogla.